

KONTRATE KONÇESIONI
PER KULTIVIMIN E ULLIRIT DERI NE 1000 HA
NE SYNEJ, LUZ I VOGEL, KRYEVIDH DHE GOSE,
KAVAJE.

Tirane, 7 Janar 2009

MËNISTRIA E BUJQESISE,
USHQIMIT DHE MBROJTJES SE KONSUMATORIT

DHE,

SHOQERIA "AGROTAL 1" SH.A.

Permbajtja

Nenet	Titulli	
1.	Perkufizimet dhe interpretimi	7
2.	Kushte Paraprake te Deklaruar per Dhenien me Koncesion	8
3.	Dhenia e Koncesionit	9
4.	Data Efektive e Kontrates	14
5.	Plani i projektit	14
6.	Testimi	15
7.	Vonesat ne zbatim	15
8.	Monitorimi	17
9.	Vonesat ne arritjen e Planit te Projektit per shkak te Autoritetit	17
10.	Pergjegjesite e Koncesionarit	18
11.	Pasojat per shkak te Autoritetit ne fazen Operacionale	18
12.	Permiresimi i Projektit dhe Sherbimeve	19
13.	Çeshtje financiare	19
14.	Rregullimi	21
15.	Nenkontraktimi	21
16.	Rishikimi i Projektit dhe sherbimeve	21
17.	Kontrollet	21
18.	Rregjistrat dhe raportet	22
19.	Garanci	22
20.	Punesimi	22
21.	Detyrime te Autoritetit	23
22.	Te drejta dhe detyrime te Koncesionarit	26
23.	Forca madhore	28
24.	Demshperblimet	29
25.	Konfidencialiteti	29
26.	Kufinjte e Penaliteteve	30
27.	Sigurimi	30
28.	Deklarime	30
29.	Zgjidhja e Kontrates	31
30.	Pasojat e Tjera te Përfundimit	34
31.	Sigurimi i Kontrates	34
32.	Transferimi i Kontrates	35

33.	Marreveshja e Palëve	35
34.	Ndarja	36
35.	Ndryshimet e kontratës	36
36.	Kontrata si një e Tere	36
37.	Fosilet dhe antikuaret	36
38.	Njofimet	36
39.	Ligji rregullues dhe Arbitrazhi	37

ANEKSET

Aneksi 1 Perkufizimet

Aneksi 2 Kerkesat e Autoritetit (Dokumentat e tenderit të publikuara me ____ 2008)

Aneksi 3 Oferta e Konçesionarit (Dokumentet e Ofertes së paraqitur të datës ____, 2008)

Aneksi 4 Çeshtje Financiare

Aneksi 5 Dhenie në Dorezim nga Autoriteti tek Konçesionari

Aneksi 6 Procedura e Kontrollit të Ndryshimeve

Aneksi 7 Dorezimi nga Konçesionari tek Autoriteti

Aneksi 8 Plani i Projektit

Aneksi 9 Plani i Testimit

Aneksi 10 Zgjidhja e Mosmarreveshjeve

Aneksi 11 Sigurimi i Kontrates

Aneksi 12 Pershkrimi i Siperfaqes prej 1000 ha

Aneksi 13 Kushtet Standarte te Nenkontraktimit

KJO KONTRATE, lidhet sot me 7 Janar 2009

NDERMJET:

Ministrise se Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit (ne vazhdim referuar si **“Autoriteti”**) e percaktuar si e tille me Vendimin e Keshillit te Ministrave, Nr. 51 date 16.01.2008,

“Per percaktimin e Autoritetit Kontraktues, per dhenien me koncesion te sipërfaqes se tokes deri ne 1000 ha (jo me pak se 700 ha) per kultivimin e ullirit, ne Komunitat Synej, Luz i Vogel, Kryevidh dhe Gose, dhe miratimin e Bonusit, ne proceduren per zgjedhese konkurruese, qe i jepet shoqerise “AGROTAL-1” Sh.A »

perfaqesuar nga Zj. Merita PETUSHI, ne detyren e Sekretares se Pergjithshme, sipas Autorizimit nr. 5593.prot, date 30.12.2008, te leshuar nga Titullari i Autoritetit (Ministri),

DHE,

Shoqerise “AGROTAL 1” Sh.A., (ne vazhdim referuar si **“Konçesionari”**), e regjistruar si person juridik shqiptar me Vendimin e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane nr. 37863, date 29.3.2007,

perfaqesuar nga Majlinda Velo,s'

ne cilesine e Drejtorit Ekzekutiv.

TE DHENA PARAPRAKE

Ne perputhje me sa vijon:

- Ligjin Nr. 9663, date 18.12.2006 *“Per koncesione”* (i ndryshuar);
 - Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 27, date 19.1.2007 *“Mbi miratimin e kritereve te vleresimit ne lidhje me dhenien e koncesioneve”* (i ndryshuar);
 - Vendim i Keshillit te Ministrave, nr. 51 date 16.01.2008 *“Per percaktimin e Autoritetit Kontraktues, per dhenien me koncesion te sipërfaqes se tokes deri ne 1000 ha (jo me pak se 700 ha) per kultivimin e ullirit, ne Komunitat Synej, Luz i Vogel, Kryevidh dhe Gose, dhe miratimin e Bonusit, ne proceduren per zgjedhese konkurruese, qe i jepet shoqerise “AGROTAL-1” Sh.A »*
 - Udhëzim Nr. 1, date 7 janar 2008, *“Per dokumentacionin e domosdoshem per te kerkuar Leje Mjedisore”*;
 - Ligji Nr. 8934, date 5 shtator 2002, *“Per mbrojtjen e mjedisit”*;
 - Ligji Nr.9817, Date 22.10.2007 *“Per Bujqesine dhe Zhvillimin Rural”*;
 - Ligji nr.8752, date 26.3.2001 *“Per krijimin dhe funksionimin e strukturave per administrimin dhe mbrojtjen e tokes”*;
-

- Ligj nr.9048, date 07.04.2003 “Per trashëgimime kulturore”;
- “Konventa Europiane per mbrojtjen e trashëgimise arkeologjike”, miratuar me Ligjin nr.9806 dt.17.09.2007;
- Kodi Civil i Republikes se Shqiperise;
- Etj.

Autoriteti eshte i autorizuar qe te nenshkruaje kete Kontrate;

NDERSA:

- (A) Me date 16.01.2008, Keshilli i Ministrave i Republikes se Shqiperise ne kuader te nismes “Shqiperia 1 Euro”, permes Vendimit Nr. 51, “Per percaktimin e Autoritetit Kontraktues, per dhenien me koncesion te siperfaqes se tokes deri ne 1000 ha (jo me pak se 700 ha) per kultivimin e ullirit, ne Komunitat Synej, Luz i Vogel, Kryevidh dhe Gose, dhe miratimin e Bonusit, ne proceduren perzgjedhese konkurruese, qe i jepet shoqerise “AGROTAL-1” Sh.a », ka percaktuar Ministrine e Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit, si Autoritet Kontraktues;
- (B) Me date 26.05.2008, Autoriteti ka shpallur Dokumentet e Procedures se Konkurrimit per Dhenien me koncesion te siperfaqes deri ne 1000 ha, (te klasifikuar toke pa frut) per kultivimin e ullirit, (jo me pak se 700 ha), ne Komunitat Synej, Luz i Vogel, Kryevidh dhe Gose;
- (C) Me date 18.08.2008, Koncesionari ka paraqitur propozimin e tij ne lidhje me kete procedure konkurruese, propozim i cili eshte pranuar nga Autoriteti;
- (D) Me date 06.10.2008, Autoriteti i ka derguar Koncesionarit “Njoftimin e Fituesit”, (Dokumenti Nr. 3274/18 prot.) duke pranuar propozimin e paraqitur nga ky i fundit;
- (E) Autoriteti dhe Koncesionari angazhohen ne baze te kesaj Kontrate me qellim per te vene ne zbatim Koncesionin, sipas afateve dhe kushteve te percaktuara me poshte;
- (F) Koncesionari, brenda 30 (tridhjete) diteve nga Data Efektive e kesaj Kontrate do te themeloje nje shoqeri tregtare (ne vazhdim “Shoqeria Koncesionare”), te ciles do t'i transferohen te gjitha te drejtat dhe detyrimet e Koncesionarit sipas kesaj Kontrate, duke patur parasysh parashikimet e Nenit 22.5.1 dhe 22.5.2 te kesaj Kontrate;

1. Perkufizimet dhe interpretimi

- 1.1 Ne kete Kontrate, do te zbatohen perkufizimet e paraqitura ne Aneksin 1 (Perkufizime dhe Interpretime).
-

- 1.2 Përveçse kur përmbajtja parashikon ndryshe, në këtë Kontratë:
- 1.2.1 Njëjësi e përfshin shumësin dhe anasjelltas;
 - 1.2.2 Referimi tek njëra gjini përfshin edhe gjininë tjetër dhe gjininë asnjënëse;
 - 1.2.3 Referimi tek një Ligj ,Vendim, Rregullore, Urdhër apo Procedure përfshin referimin tek ai Ligj ,Vendim, Rregullore, Urdhër apo Procedure sic është ndryshuar, shtuar apo rimiruar kohe pas kohe dhe tek çdo akt tjetër si rrjedhim i tyre. Pasoja dhe efektet e çfaredo ndryshimi shtese apo rimiratimi te tille mbi kete Kontrate do te zgjidhet ne perputhje me Nenin 19 të kontratës;
 - 1.2.4 Çdo frazë që fillon me fjalët "duke përfshirë", "përfshin", "në veçanti", "për shembull", "të tilla si" apo të ngjashme, do të kuptohet si ilustruese dhe pa kufizim ndaj përgjithshmërisë së fjalëve të përgjithshme të lidhura;
 - 1.2.5 Titujt e përdorur për nenet, paragrafet, nënparagrafet, Aneksot dhe tabela e përmbajtjes janë verem për lehtësi referimi dhe nuk do të ndikojnë në interpretimin e kësaj Kontrate;
 - 1.2.6 Një referim tek një ent shtetëror nënkupton referencën tek juridiksioni i tij dhe nese ky ent shtetëror:
 - (i) zevendesohet nga një organ/ent tjetër, atëherë i referohet juridiksionit të këtij të fundit;
 - (ii) pushon se ekzistuar, atëherë i referohet juridiksionit të organit/entit, i cili ka kompetenca të përafërta ose të njëjta me organin/entën shtetëror qe ka pushuar se ekzistuar.
- 1.3 Referimet në dispozitat dhe Aneksot janë, përveç rastit kur parashikohet ndryshe, referime tek dispozitat dhe anekset e kësaj Kontrate.
- 1.4 Pa paragjykim ndaj paragrafeve te mesiperem, nese ka ndonje konflikt apo mosperputhje ndermjet neneve dhe Anekseve dhe/ose ndonje shtojce te Anekseve dhe/ose cdo dokumenti tjetër qe i referohemi ne kete Kontrate, konflikti apo mos perputhja do te zgjidhet sipas rendit te meposhtem te perparetise, duke bërë interpretimin në mirëbesim:
- 1.4.1 Aneksi 1 (Përkufizime);
 - 1.4.2 Aneksi 2 (Kërkesat e Autoritetit);
 - 1.4.3 Aneksi 3 (Oferta e Konçesionarit);
 - 1.4.4 Aneksi 4 (Çështje Financiare);
 - 1.4.5 Çdo Aneks tjetër dhe shtojcat e tyre;
 - 1.4.6 Çdo dokument tjetër që i referohemi në këtë Kontrate ose çdo dokument tjetër bashkëlidhur kësaj Kontrate.
-

- 1.5 Duke i'u nenshtruar dispozitave të Neneve 6 dhe 7, asnjë Palë e kesaj Kontrate nuk do të jetë përgjegjëse për pamundësinë e zbatimit të detyrimeve të saj bazuar në këtë Kontrate deri në masën që kjo pamundësi është shkaktuar nga një dështim ose vonesë nga Pala tjetër në realizimin e detyrimeve të saj bazuar në këtë Kontrate. Pala e ndikuar do të njoftojë Palën tjetër për një dështim apo vonesë të tillë brenda 30 ditëve nga data që kjo Palë bëhet e vetëdijshme për këtë ngjarje dhe efektet e saj të mundshme.

2. Kushte Paraprake të deklaruar për Lidhjen e Kontratës

2.1 Koncesionari deklaron që:

- 2.1.1 Ka bërë dhe do të bëjë kerkimet dhe studimet e tij për zbatimin dhe permbushjen e detyrimeve të tij bazuar në këtë Kontrate, duke përfshirë informacionin e vënë në dispozicion nga Autoriteti, dokumentet standarte, dhe çdo lloj informacioni të kërkuar nga Koncesionari përpara datës së lidhjes së kësaj kontrate.
- 2.1.2 Është në dijeni të plotë persë i përket permbajtjes dhe kërkesave të Autoritetit të përcaktuar në Aneksin 2 (Kërkesat e Autoritetit) dhe Aneksin 3 (Oferta e Koncesionarit); dhe,
- 2.1.3 Ka të gjithë informacionin, pajisjet, sistemet dhe personelin e nevojshëm dhe të kualifikuar me qëllim që t'i japë mundësi atij të zbatojë detyrimet që rrjedhin nga kjo Kontrate, duke përfshirë mundësinë për të permbushur dhe realizuar Projektin Koncesionar.
- 2.1.4 Në asnjë rast nuk do të kërkojë ndonjë demshperblim, penalitet apo të ngrejë çfaredolloj pretendimi në lidhje me zbatimin e Kontrates ndaj Autoritetit, apo Enteve të tjera në varesi të tij, për fakte, rrethana apo ngjarje që ka dijeni dhe/ose duhet të ishin parashikuar prej tij në projektin dhe në Aneksin 3 (Oferta e Koncesionarit), me përjashtim kur faktet, rrethanat apo ngjarjet janë deklaruar si të vërteta apo ekzistuese, sipas paragrafit 2.2 më poshtë;
- 2.1.5 Koncesionari brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data efektive e kesaj kontrate do të themelojë një Shoqëri Tregtare në vazhdim "Shoqëria Koncesionare", të cilit do të transferohen të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Koncesionarit sipas kesaj kontrate, duke patur parasysh parashikimet e Nenit 33 të kesaj kontrate.

2.2 Autoriteti deklaron që:

- 2.2.1 Autoriteti të gjitha të dhënat e tij të vëna në dispozicion të koncesionarit duke përfshirë dhe Dokumentet e Procedurës Konkurruese, janë të sakta, të vërteta dhe pa gabime.
- 2.2.2 Kjo Kontrate është nënshkruar rregullisht, nga Autoriteti, i cili gëzon të gjitha të drejtat dhe kompetencat në baze të legjislacionit shqiptar.

2.2.3 Autoriteti do te dorezoje prane Keshillit te Ministrave menjehere pas nenshkrimit kete Kontrate, ne formen e nje projekt-ligji, i cili do te jete objekt shqyrtimi nga ky i fundit. Autoriteti nuk garanton ne asnje rast miratimin pa kushte apo detyrime te tjera te kesaj Kontrate, si ne Keshillin e Ministrave ashtu dhe ne Kuvendin e Shqiperise.

2.2.4 Nenshkrimi dhe zbatimi i kesaj Kontrate i nenshtrohet ligjeve ne fuqi te Republikes se Shqiperise.

2.2.5 Asnje urdher, rregull/rregullore, urdher ekzekutimi, vendime, pezullim ose urdher kufizues me karakter administrativ nuk do te zbatohet ose urdherohet te zbarohet nga ndonje organ pushteti administrativ ose Ent Shteteror qe ka juridiksion mbi çështjen qe kufizon, ndalon ose deklaron te paligjshme aktivitetet e kryera sipas kesaj Kontrate.

3. Dhënia e Konçesionit

3.1 Objekti i Konçesionit

3.1.1 Duke ju nenshtuar dhe në përputhje me afatet dhe kushtet e përcaktuara në këtë Kontrate dhe Anekset bashkëlidhur, Autoriteti jep dhe autorizon Konçesionarin, të Projektojë, Ndërtojë, Vërë në shfrytëzim, Administroje, Mirëmbaje masivin e ullishtes, tregtimin e ullirit, si dhe të transferoje masivin e ullirit në përfundim të kontratës nga Konçesionari tek Autoriteti Kontraktues, konform kushteve dhe afateve të parashikuara në këtë Kontratë.

3.1.2 Në vijim, për qëllimin e objektit të kësaj Kontrate, Konçesionari do të sigurojë përgatitjen, përcaktimin, zhvillimin, zbatimin dhe operimin në tërësi të këtyre proceseve, sipas rastit:

1. Ngritja e masivit të ullishtes do të përfshijë punimet e mëposhtme:

- (i) marrja e masave për ndërtimin e infrastrukturës;
 - (ii) shpyllëzimi i territorit;
 - (iii) sistemimi sipërfaqësor i terrenit;
 - (iv) organizimi i territorit;
 - (v) plehërimi bazë organo-mineral;
 - (vi) punimi i thellë Qilizëm;
 - (vii) punime të tjera pas mbjelljes;
 - (viii) punime për pikeumet;
 - (ix) distancat e mbjelljes;
 - (x) vendosja e sistemit të ujitjes;
 - (xi) mbjellja e fidaneve;
-

- (xii) vendosja e mjeteve mbështetëse ;
 - (xiii) etj,
2. Shërbimet në ullishte pas mbjelljes;
- (i) Plehërimi dhe ujitja sistematike;
 - (ii) Krasitja dhe formimi;
 - (iii) Mbrojtja fitosanitare;
 - (iv) Sistemi racional i vjeljes;
-
3. Plehërimi dhe ujitja;
- (i) përzgjedhja e dozave dhe llojeve të plehërimit;
 - (ii) plehërimi gjethor;
 - (iii) plehërimi me ujitje;
 - (iv) plehërimi në tokën e livadhëzuar të ullishtes;
 - v) ujitja,
 - (vi) etj,
4. Formimi i kurorave të ullirit:
- (i) perzgjedhja e formave te kurorave, te tilla si: shkurore, vazo polikonike, vazo shkurore, monokonike, palmete elipsoidale;
 - (ii) mirëmbajtja e kurorave;
 - (iii) etj.
5. Zgjidhja e problemeve fitosanitare;
- (i) njohja e dëmtimeve të rrezikshme për kulturën;
 - (ii) përcaktimi i kriterëve bazë mbi të cilët vlerësohet prania dhe niveli i rrezikshmërisë së dëmtuesve dhe sëmundjeve;
 - (iii) përcaktimi i produkteve fitosanitare të lejuara për përdorim;
6. Praktika kulturale të kryera deri në futjen në prodhim të plotë të plantacionit.
- (i) mbajtja e tokës me bimësi;
 - (ii) mbajtja nën kontroll për monitorimin e dëmtuesve dhe sëmundjeve;
 - (iii) ujitja;
 - (iv) krijimi i kurorave;
 - (v) etj.
7. Praktika kulturale të kryera me futjen e ullinjve në prodhim të plote.
- (i) mobilizim dhe trajnim i krahut te punes;
 - (ii) mbrojtja nga gërryerjet;
 - (iii) mirembajtja e rrjetit antierozion dhe ndërtimi i rrjetit të rrugëve;
 - (iv) trajnim i tokës nën ullishte;
-

- (v) plehërimi;
- (vi) ujitja;
- (vii) krasitja;
- (viii) zgjidhja e problemeve fitosanitare;
- (ix) vjelja;
- (x) etj.

8. Investime të tjera ne ngritjen/ndërtimin e infrastrukturës përkatëse si-zyra, depo, rrugë, impjante veditje spërkatje pleherimi organik, teknologji bashkohore.

9. Mbrojtja e fosileve, antikuareve dhe pasurive arkeologjike.

3.1.3 Afatet e vendosura në Aneksin 8 Planit i Projektit i miratuar nga palët, mund të shtyhen për një periudhë të caktuar kohe e barabartë me vonesat kohore të shkaktuara nga Autoriteti apo çdo Ent Shtetëror, në dhënien e një license, leje apo autorizimi që kërkohet për përmbushjen e ketyre detyrimeve.

3.2 Periudha e Konçesionit

3.2.1 Konçesioni jepet per nje periudhe prej 99 vjetesh nga data efektive dhe perfundon ne ditën e pervjetorit te 99-te te dates Efektive "Periudha Efektive". Megjithate ne rastin e zgjidhjes perpara afatit 99 vjecar periudha e Konçesionit do te nenkuptoje dhe do te kufizohet tek periudha qe fillon nga Data Efektive dhe mbaron ne Daten e Zgjidhjes.

3.3 Rastet e zgjatjes së Periudhës së Konçesionit

3.3.1 Pas një periudhë prej 95 (nëntëdhjetë e pesë) vitesh duke filluar nga Data Efektive, Palët bien dakort për të diskutuar pa detyrime, afatet dhe kushtet për një zgjatje të mundshme të Periudhës së Konçesionit, duke patur parasysh së Autoriteti mund të angazhohet në zgjatjen e afatit, në rastin e ekzistencës së interesit publik dhe përputhshmërisë me strategjinë dhe objektivat e tij në momentin e negociatave. Çdo zgjatje e afatit mund të reflektohet mbi ato elemente të Kontratës me karakter financiar, ashtu siç mund të gjykohet e arsyeshme dhe e përshtatshme nga palët.

3.3.2 Zgjatja e Periudhës së Konçesionit do të jetë e detyrueshme për Palët, në rast se për shkaqe të arsyeshme që ndikojnë drejtpërdrejtë në Projekt (jo të shkaktuara nga Konçesionari) (këtu nuk përfshihet Forca Madhore) nevojitet një periudhë më e gjatë kohe për t'u konsideruar si rentabel dhe financiarisht i përshtatshem në përputhje me analizat financiare të "Vleres për Para", "IRR" apo çdo lloj analize tjetër të përshtatshme për vleresime të tilla.

3.3.3 Palër bien dakord së Periudha e Konçesionit do të zgjatet për një periudhë të caktuar kohe e barabarte me vonesat kohore për shkak rastit të mospërbushjes nga ana e Autoriteti apo çdo Ent Shtetëror, në dhenien e një license, leje apo autorizimi që kërkohet për përbushjen e detyrimeve të Konçesionarit, që rrjedh apo ka lidhje me këtë Kontrate, me kusht qe kjo vonese te ndikojë ne rentabilitetin dhe fizibilitetin e projektit, vleren ne para, IRR (internal rate of return).

3.3.4 Palër bien dakord së Periudha e Konçesionit do të zgjatët për një periudhë të caktuar kohe e barabarte me vonesat kohore për shkak të rastit të mospërbushjes nga ana e Autoriteti, për venien në dispozicion të Konçesionarit të sipërfaqes prej 700-1000 ha.

3.3.5 Palër bien dakord së Periudha e Konçesionit do të zgjatet në rastin e një Ngjarjeje të Forcës Madhore, për një periudhë kohe të barabarte me, kohen që ka zgjatur Ngjarja dhe kohen e arsyeshme të nevojitur për riparimin e dëmeve të shkaktuara, me kusht që vet Ngjarja të këtë zgjatur një periudhë kohe që e kalon 2 (dy) vjet me kusht qe kjo vonese te ndikojë ne rentabilitetin dhe fizibilitetin e projektit, vleren ne para, IRR (internal rate of return).

3.4 Ekskluziviteti dhe kufizimet

3.4.1 Të Drejtat e Konçesionit do të jenë ekskluzive dhe Konçesionari do të këtë të drejtën ekskluzive, në lidhje me shfrytëzimin e sipërfaqes prej 700-1000 ha, sipas Aneksit 5. Kjo e drejtë ekskluzive përfshin përshtatjen dhe shfrytëzimin e terrenit për kultivimin e varieteve të ndryshme të bimës së ullirit dhe tregimit e tij, ngritjen/ndërtimin e infrastrukturës përkatëse si zyra, depo, rrugë, impjante vaditje, spërkatje, pleherimi organik, teknologji te aplikuar sipas praktikave bashkekohore. Përvec sa me sipër, Konçesionari ka te drejte te ushtroje sherbime te tjera vetem ne qellim te realizimit te Projektit Perfundimtar te miratuar nga Autoriteti.

3.4.2 Në asnjë rast Autoriteti nuk do të lidhe dhe/ose deklaroje të lidhe çfaredolloj kontrate apo marreveshje me palë të treta të cilat mund të japin ose deklarojne të japin, të drejtat e identifikuar në Nenin 3 (Dhenia e Konçesionit) një pale të trete ose të marre ndonje veprim duke përfshire perfundimin e kontrates e cila mund të ndikojë negativisht në të drejtat ekskluzive të dhena Konçesionarit sipas kesaj Kontrate.

3.5 Autorizime, Leje dhe Liçenca

- 3.5.1 Autoriteti do të sigurojë që, çdo Ent Shtetëror nën autoritetin e drejtpërdrejtë të tij, do t'i lëshojë Koncesionarit autorizimet, licencat dhe lejet në lidhje me zbatimin e Konçesionit me kusht që Konçesionari të ketë përmbushur kërkesat ligjore për aplikimin e licencave, autorizimeve dhe lejeve të kërkuara nga ai.
- 3.5.2 Në rastet kur çdo Ent Shtetëror (i cili nuk është nën autoritetin e drejtpërdrejtë të Autoritetit) që ka të drejtë të lëshojë autorizime, leje apo licensa, Autoriteti do të bëjë cdo përpjekje për ndikuar që autorizimet, lejet dhe licencat t'i lëshohen Konçesionarit në përputhje me këtë Kontratë, pa vonesa, sipas një kërkesë të nevojshme të paraqitur nga Konçesionari, me kusht që ky i fundit të ketë përmbushur kërkesat ligjore për aplikimin e licencave, autorizimeve dhe lejeve të kërkuara nga ai.
- 3.5.3 Autoriteti do të bëjë të gjitha përpjekjet e duhura që Entet Shtetërore që ushtrojnë autoritetin e tyre përkatës në lidhje me Konçesionarin do të mbështesin pa i shkaktuar Konçesionarit vonesa në zbatimin e Projektit.
- 3.5.4 Afatet e vendosura në Aneksin 8 i miratuar nga Palet mund të shtyhen për një periudhë të caktuar kohe e barabartë me vonesat kohore të shkaktuara nga Autoriteti apo cdo Ent Shtetëror, në dhenien e një Licence, Lejeje apo Autorizimi për përmbushjen e këtyre detyrimeve si dhe në përmbushjen e cdo detyrimi tjetër të parashikuar në këtë kontratë.
- 3.5.5 Kur nuk është përcaktuar ndryshe në këtë Kontratë, me hyrjen në fuqi të Ligjit Për Miratimin e Kontratës së Koncesionit për Kulturimin e Ullirit (sipas Ligjit të Zbatueshëm), kjo Kontratë ka përparësi mbi çdo Ligj të Zbatueshëm që do të hyjë në fuqi pas datës së hyrjes në fuqi të Ligjit "Për Miratimin e Kontratës së Koncesionit për Kulturimin e Ullirit".

3.6 Dorëzimi i Mjedisëve të Konçesionit dhe Infrastrukturës

- 3.6.1 Me mbarimin e Periudhës së Konçesionit, Konçesionari do të dorëzojë tek Autoriteti Masivin e Ullirit të realizuar nga Shoqëria Koncesionare gjatë periudhës së konçesionit si dhe çdo titull mbi këtë masiv pa asnjë lloj detyrimi, barre apo hipoteke.
- 3.6.2 Proçesi i Dorëzimit do të fillohet të paktën 6 (gjashtë) muaj përpara datës së mbarimit të Periudhës së Konçesionit nga një inspektim i përbashkët i Autoritetit dhe Konçesionarit.

3.7 Proçedura e Dorëzimit

- 3.7.1 Transferimi do të përfshijë por pa u kufizuar në:
-

- i) Dorëzimin fizik të Masivit të Ullirit të Shoqërisë Koncesionare;
 - ii) Dorëzimin e inventarit të Aseteve me vlerën kontabel të mbetur në momentin e dorëzimit si dhe të dhënat në posedim të tij në lidhje me të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me operimin e Koncesionit nga Shoqëria Koncesionare, pa pagesa, detyrime apo tarifa të mëtejshme;
 - (iii) Kalimin e titullit të pronësisë për ndërtesat apo impiantet e ndërtuara nga Shoqëria Koncesionare.
-

3.7.2 Autoriteti bie dakord dhe merr përsipër që brenda 30 ditëve nga transferimi i të drejtave dhe titujve në lidhje me asetet dhe dorëzimin e dokumenteve përkatëse siç është parashikuar në paragrafët me lart, ai do të lëshojë Çertifikatën e Dorëzimit në përputhje me Aneksin 7 (Çertifikata e Pranimit të Dorëzimit) të kësaj Kontrate. Koncesionari duhet të dorëzojë këto asetë në gjendje funksionale.

3.7.3 Ndërsa të gjitha asetet e sipërpërmendura të Shoqërisë Koncesionare do të transferohen tek Autoriteti në ditën e përfundimit të Periudhës së Koncesionit, vetë Shoqëria Koncesionare (si person juridik) si dhe Koncesionari me asetet e tij, nuk do të transferohen tek Autoriteti.

4. Data Efektive e Kontratës

4.1 Data Efektive:

4.1.1 Data Efektive e kësaj Kontrate do të jetë 15 ditë pas botimit të Ligjit të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë "Për Miratimin e Kontratës së Koncesionit për Kulturimin e Ullirit", në Fletoren Zyrtare përkatëse të Republikës së Shqipërisë.

4.2 Mosarritja e respektimit të Datës Efektive.

Ne rast se Data Efektive nuk hyn në veprim brenda një periudhe prej 120 ditësh që nga data e nënshkrimit të kësaj Kontrate, secila nga palët do të ketë të drejtën që zgjidhë kontratën, duke dhënë një Njoftim Zgjidhjeje ndaj palës tjetër. Në vijim të marrjes së një Njoftim Zgjidhjeje të tillë, Palët në këtë Kontratë nuk do të kenë të drejta apo detyrime të mëtejshme sipas kësaj Kontrate (përveç të drejtave dhe detyrimeve të tilla të parashikuara në nenin 25 (Konfidencialiteti) dhe nenin 39 (Ligji rregullues dhe Arbitrazhi).

5. Plani i Projektit

Koncesionari do të realizojë projektin në përputhje me Planin e Projektit, të parashikuar në Aneksin 8.

6. Testimi

- 6.1** Kur Konçisionari të konsiderojë se Projektu është gati për t'u restuar, ai do të paraqesë Projektin për testim dhe Palët do të ndjekin dispozitat e zbatueshme të Procedurave të Testimit, parashikuar ne Aneksin 9 të kësaj kontrate. Testimi do të fillojë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit të bërë nga Konçisionari tek Autoriteti Kontraktues. Ky testim do të kryhet nën kontrollin e një grupi pune në rang-ekspertësh me përfaqësues të Autoritetit Kontraktues dhe të Shoqërisë Konçisionare, në përbërje të të cilit do të ketë edhe eksperte të institucioneve të specializuara të pavarura të fushës, të cilët do të konkludojnë me një raport përfundimtar për vënien ose jo në punë të Projektit, brenda 30 ditëve nga fillimi i testimit, duke patur parasysh kompleksitetin e veprës.
- 6.2** Nëse Konçisionari i kalon me sukses procedurat e testimit, Autoriteti do të lëshojë një Çertifikate Pranimit. Lëshimi i një certifikate të tillë konfirmon ideimin, zhvillimin dhe realizimin e projektit në përputhje me këtë Kontratë. Pavarësisht nga lëshimi i çfarëdo Çertifikate Pranimit, Konçisionari do të mbetet i vetmi përgjegjës për të siguruar që Projektu, siç është ideuar dhe zhvilluar, të jetë i përshtatshëm për realizimin e tij, në përputhje me këtë Kontratë.
- 6.3** Në rast se gjatë procesit të testimit, Autoriteti konstaton mospërputhje në realizimin e projektit apo të nivelit të shërbimeve, atëherë ai ka të drejtë të refuzojë lëshimin e Certifikatës së pranimit, duke aplikuar penalitetet e parashikuara në Aneksin 4 të kësaj Kontrate.
- 6.4** Nëse Konçisionarit nuk i jepet Certifikata e Pranimit pas përfundimit me sukses të testimit, pas një periudhe tolerimi prej 7 dite pune, atëherë projektin do të konsiderohet i realizuar në përputhje me Kontratën, pavarësisht datës së lëshimit të Certifikatës.
- 6.5** Në rast mospjesëmarrjeje të Autoritetit gjatë testimit Konçisionari ka të drejtë të kryejë vetë testimin dhe vënien në punë të projektit duke njoftuar Autoritetin me shkrim, brenda 20 ditëve pune nga përfundimi i testimit. Në këtë rast projektin do të konsiderohet i realizuar në përputhje me kontratën, pavarësisht lëshimit të Certifikatës.
- 6.6** Të gjitha shpenzimet për kryerjen e testimit do të perballohen nga Konçisionari.
- ## **7. Vonesat në zbatim – Dispozita të Përgjithshme**
- 7.1** Nëse, në çdo kohë, Konçisionari është në gjendje të parashikojë se ai nuk do të (apo se ka pak të ngjarë që të) arrijë cilindo nga afatet e parashikuara në Aneksin 8 (Plani i Projektit), ai do të njoftojë menjëherë Autoritetin mbi faktin e Vonesës duke bërë një përmbledhje të shpjegimeve përkatëse.
- 7.2** Konçisionari, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në çdo rast jo më vonë se sa 10 ditë
-

pune pas njoftimit fillestar sipas Nenit 7.1, do t'i japë Autoritetit hollësi të plota me shkrim për:

- 7.2.1 Arsyet e Vonesës;
- 7.2.2 Pasojat e Vonesës;
- 7.2.3 Nëse Konçesionari pretendon se Vonesa vjen për shkak të Autoritetit, arsyen pse e paraqet atë pretendim.

7.3 Në rast se vonesa vjen si pasojë e mospërbushjes së detyrimeve të Autoritetit, Konçesionari do të ndermarre të gjitha hapat e arsyeshme për të shmangur apo zvogëluar pasojat e Voneses, aq sa mund të jete e mundur dhe e perballueshme financiarisht, me kusht që çfarëdo kostosh të tilla shtesë të pësuara nga Konçesionari për shkak të Pazotësisë së Autoritetit t'i jenë njoftuar paraprakisht me shkrim ketij te fundit te pakten 20 (njetzet) dite perpara kryerjes se shpenzimeve te tilla. Konçesionari është i detyruar të respektojë këtë procedurë, me përjashtim të një situatë emergjente kur ai për të shmangur efektet negative të vonesës nuk ka kohë të mjaftueshme për të njoftuar Autoritetin. Në cdo rast Konçesionari do të rimbursohet nga Autoriteti për të gjitha shpenzimet e arsyeshme dhe të nevojshme shtese të kryera si rezultat i një situatë të tillë, brenda një periudhë kohore jo më shumë se 20(njetzet) dite pune nga celja e fondeve buxhetore të Autoritetit për vitin pasardhës, nëse detyrimi për rimbursim lind brenda 6 (gjashtë) mujorit të parë të një viti kalendarik. Nëse ky detyrim lind brenda 6 (gjashtë) mujorit të dytë të një viti kalendarik atëherë shpenzimet do të paguhet brenda 20 diteve nga mbarimi i një periudhë prej 19 (nëntembdhjetë) muajsh që fillon nga momenti i lindjes dhe njoftimit të detyrimit.

7.4 Çfarëdo konflikti mes palëve, si rrjedhojë e vonesave do të zgjidhet përmes procedurës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të parashikuara në Aneksin 10. Gjatë kohës së zgjidhjes së konfliktit të dy palët do të vazhdojnë të punojnë për të zgjidhur shkaqet apo për të zvogëluar pasojat e Voneses.

7.5 Nëse është e mundur Konçesionari do të paraqesë një projekt të planit të korrigjimit, në rast se nuk është në gjendje të arrijë afatet e parashikuara sipas planeve vjetore të deklaruara prej tij. Projekt-Plani i Korrigjimit do të identifikojë çeshtjet që rrjedhin nga vonesa dhe hapat që konçesionari propozon që të ndermerren për të arritur afatet në përputhje me këtë Kontratë.

7.6 Projekt Plani i Korrigjimit do të paraqitet Autoritetit për miratim sa më shpejt që të jete e mundur dhe në cdo rast jo më vonë se 45 dite pune (apo një periudhë kohore tjetër të tillë që autoriteti mund të lejojë dhe të njoftojë Konçesionarin me shkrim pas njoftimit fillestar

sipas nenit 7.1. Autoriteti nuk do te refuzoje miratimin e tij per nje Projekt Plan Korrigjimi ne menyre te paarsyeshme. Autoriteti do te shprehet mbi propozimin e Koncesionarit brenda 15 diteve pune nga paraqitja e kerkeses, ne rast te kundert propozimi konsiderohet i miratuar nga ana e Autoritetit.

7.7 Koncesionari do te veproje ne perputhje me Planin e tij te Korrigjimit.

7.8 Palet bien dakord qe marrja nga Koncesionari dhe/ose Nen- kontraktuesit e tij, e te gjitha licensave, autorizimeve dhe lejeve te kerkuara per ekzekutimin e projektit, eshte thelbesore per zbatimin e kesaj kontrate. Ne rast vonese ne marrjen e licensave, autorizimeve dhe lejeve te tilla, te shkaktuara nga organet kompetente si rezultat i tejkalimit te afateve ligjore per dhenien e tyre, Autoriteti ose Enti Shreteror nuk do te konsiderohet ne vonese deri ne nje periudhe 20 (njezet) Dite Pune nga kalimi i afatit ligjor per dhenien e tyre.

8. Monitorimi

8.1. Autoriteti Kontraktues, ka te drejte qe ne periudha kohore prej 6 muajsh, gjate periudhes se koncesionit, nepermjet te autorizuarve te tij, pas njoftimit paraprak te Shoqerise Konkensionare, te monitoroje objektin e koncesionit per te verifikuar zbatimin e detyrimeve qe rrjedhin nga kontrata ne te gjitha fazat e zbatimit te saj. Megjithate, Autoriteti mund te ushtroje kete monitorim ne cdo kohe, ne rast se ka informacione te arsyeshme dhe te besueshme ne lidhje me mosekzekutimin e detyrimeve te kesaj kontrate. Ne rast te mospërbushjes se detyrimeve nga ana e Koncesionarit, te konstatuara gjate monitorimit, Koncesionari do te njoftohet me shkrim per masat qe do te merren dhe detyrat qe do t'i lihen si dhe afatet e arsyeshme te zbatimit te tyre. Kur eshte rasti do te zbatohen edhe penalitete sipas Aneksit 4.

9. Vonesat ne arritjen e Planit te Projektit per Shkak te Autoritetit

9.1 Pa paragjykim ndaj Nenit 7.3 dhe duke iu nenshtuar Nenit 7.4, nese Koncesionari do te kishte qene ne gjendje qe te arrinte afatet sipas Aneksit 8, por nuk ka arritur ta beje kete si pasojë e rastit te mospërbushjes nga e Autoritetit, atehere Koncesionari pasi te kete njoftuar paraprakisht me shkrim Autoritetin mbi shkakun/pasojen e voneses, do te perfitoje nga te drejtat dhe lehtesimet e percaktuara ne kete Nen.

9.2 Nese vonesat kanë ardhur si pasojë e rastit te mospërbushjes nga Autoriteti, atehere Koncesionari:

9.2.1 do te kete te drejten e zgjatjes se afatit per nje periudhe te barabarte me Vonesen e shkaktuar per Shkak te Autoritetit, ne zbatim te Nenit 3.3.2.

9.2.2 nuk do te konsiderohet se eshte ne shkelje te kesaj Kontrate si rrjedhim i mosarritjes per te Permbushur afatet sipas Aneksit 8;

- 9.2.3 nuk do të jetë subjekt i pagimit të penalteteve, në lidhje me mosarritjen e afateve në masen që Vonesa vjen drejtperdrejt për Shkak të Autoritetit; dhe
- 9.2.4 do të ketë të drejtën të ngrrej pretendime për shpenzimet e kryera për shkak të Autoritetit, në përputhje me parashikimet e nenit 7.3.

10. Përgjegjësite e Koncesionarit

10.1 Koncesionari do të siguroje që projekti të jetë në përputhje me:

10.1.1 Kërkesat e Autoritetit siç përcaktohet tek Aneksi 2 (Kërkesat e Autoritetit);

10.1.2 Ofertën e Koncesionarit të parashikuar në Aneksin 3;

10.1.3 Këtë Kontratë;

10.1.4 Anekset e parashikuara në këtë Kontratë;

10.2 Koncesionari do të zbatojë projektin në përputhje me:

10.2.1 Në përputhje me praktikat bashkohore në këtë fushë;

10.2.3 Planet e Cilësisë;

10.2.4 Nivelin e aftësive profesionale, kujdesit, planifikimit, mbikqyrjes, kontrollit dhe gjyqimit të cilat mund të priten nga një shoqëri profesioniste me përvojë në dhënien shërbimeve të tipit dhe kompleksitetit të kërkuar nga Autoriteti sipas kësaj Kontrate.

10.3 Përbushja e detyrimeve

10.3.1 Koncesionari do të përbushë detyrimet në përputhje me parashikimet e vendosuar në pikat 10.1 e 10.2 të këtij neni.

10.3.2 Nëse ka një dështim në përbushjen e një/disa detyrimeve apo nëse Koncesionari beson se do të ketë një Dështim në përbushjen e një/disa detyrimeve, Koncesionari do të:

- (i) njoftojë Autoritetin menjëherë për Dështimin apo Dështimin e mundshëm në përbushjen e detyrimit;
- (ii) sigurojë pranë Autoritetit një Plan Korigjimi të afateve dhe veprimeve që ai do të ndërmarë për të ndrequr Dështimin, brenda 15 ditëve pune nga data që Koncesionari njofton Autoritetin sipas Nenit 10.3.2 (i);
- (iii) vëre në përdorim të gjitha burimet shtese dhe do të ndërmarë të gjitha veprimet rregulluese që janë të nevojshme për të ndrequr apo për të parandaluar Dështimin në të ardhmen.

11. Pasojat per Shkak të Autoritetit në Fazën Operacionale

11.1 Nëse Koncesionari do të realizonte të drejtat ekskluzive të tij dhe përbushte detyrimet në fazën operacionale në përputhje me këtë Kontratë, por ka dështuar si pasojë e

mospërbushjes nga ana e Autoritetit, Koncesionari do te kete te drejtat dhe asistencen e parashikuar si me poshte:

11.1.1 Nuk do te trajtohet si te jete ne mospërbushje te kesaj kontrate;

11.1.2 Do te kete te drejten te ngreje pretendime per shpenzimet e kryera, ne perputhje me Nenin 7.3;

~~11.2 Në prirje të zgjidhjeve të konflikteve të dyja palët do të vazhdojnë të zgjidhin çështjet dhe të zbusin efektet e këtij dëshimi.~~

12. Përmirësimi i Projektit dhe Shërbimeve

12.1 Gjate gjithë Periudhës së Koncesionit, Koncesionari është i detyruar të identifikojë përmirësime të reja ose potenciale të Projektit në pajtim me këtë Nen. Në këtë kuader Koncesionari, ka të drejte të identifikojë dhe raportoje prane Autoritetit, për:

- (i) Nevojën e teknologjive përkatëse të reja dhe të zhvilluara, të cilat mund të përmirësojnë Shërbimet, dhe këto teknologji të zhvilluara potencialisht të mundshme për Koncesionarin dhe Autoritetin, të cilat Palët duan të adoptojnë; dhe/ose
- (ii) Përmirësime të reja ose të mundshme të Shërbimeve duke përfshirë cilësinë, përgjegjshmërinë, procedurat, si mekanizmat e performancës dhe shërbimet mbështetëse të klientit në lidhje me Shërbimet.

12.2 Koncesionari do të sigurojë që informacioni që do ti jepet Autoritetit të jetë i mjaftueshëm për Autoritetin që të përcaktojë nëse duhet të zbatohet përmirësimi. Koncesionari do të japë çdo informacion të mëtejshëm që Autoriteti kërkon.

12.3 Nëse Autoriteti dëshiron të përfshijë ndonjë përmirësim të identifikuar nga Koncesionari, Autoriteti do ti dërgojë Koncesionarit një njoftim dhe palët do:

- (i) Zhvillojnë një plan për zbatimin e përmirësimit brenda një afati 20 ditë pune të Kërkeses së Ndryshimit të Autoritetit, për aprovimin e Autoritetit;
- (ii) Zbatojnë përmirësimin në përputhje me parashikimet e një plani të zbatimit, i miratuar nga Autoriteti;

13. Çështje financiare

13.1 Vlerësimi i investimeve

Në përputhje me ofertën e Koncesionarit, vlera e investimit për realizimin e Projektit është 1,906,500 leke/ha. Vlera e ndryshuar e investimit mund të jetë më e madhe se 1,906,500 leke/ha, por jo me e vogël se 1,811,175 leke, (që perfaqeson një ndryshim të investimit në vlerën 5% të investimit total të parashikuar). Në fund të cdo viti (viti fillon nga data efektive e Kontrates) do të paraqitet plani i punimeve nga Koncesionari për vitin pasardhës. Autoriteti ka të drejtë të monitorojë përmbushjen e vlerës së investimit sipas

fazave të investimit dhe planit të punimeve të ndara në 7 vite. Moskryerja e planit të punimeve në zëra dhe vlera të paraqitura në fund të vitit për vitin parardhës nga Koncesionari, do të shoqërohet me penalitete vetëm pas vitit të tretë të fillimit të punimeve për vlerën e përealizuar, sipas Aneksit 4.

13.2 Tarifa e Koncesionit

Koncesionari do të paguajë një tarifë ("Tarifa e Koncesionit") që arrin në 0,2% të të ardhurave vjetore të realizuara nga shitjet, (duke përjashtuar TVSH-në), në favor të Autoritetit për të drejtat dhe privilegjet e dhëna në këtë Kontratë, bazuar në deklaratimet financiare të kontrolluara të Shoqërisë Koncesionare për çdo Vit Financiar. Detyrimi i Koncesionarit për pagesën e kësaj Tarife, fillon nga viti i parë i realizimit të të ardhurave nga ky Projekt.

13.3 Modalitetet e pagesës

Tarifa e Koncesionit bëhet e kërkueshme me baze vjetore, dhe paguhet brenda 30 ditëve nga depozitimi i detyrueshëm i bilancit të Shoqërisë Koncesionare për efekt fiskal, sipas legjislacionit në fuqi.

Vonesa në pagimin e kësaj tarife do të shoqërohet me penalitetet e parashikuara në Aneksin 4 (Çështje financiare).

13.4 Riinvestimi

Koncesionari do kryejë çdo 30 vjet riinvestim në ullishte dhe teknologji në vlerën 20% të vlerës totale të investimit, përkatësisht 60% të vlerës së riinvestimit në ullishte dhe 40% në teknologji. Këto vlera do të aktualizohen sipas indeksit të inflacionit.

13.5 Rishikimi i kostove dhe shpenzimeve

Në rast se secila nga Palët do të kërkojë rishikim të kostove dhe shpenzimeve të Koncesionit, duhet të njoftojë Palën tjetër me shkrim, duke respektuar Procedurën e Ndryshimeve të Kontratës, Aneksi 6 i kësaj Kontrate. Brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit, Palët do të takohen dhe do të diskutojnë mbi rishikimin e kostove dhe shpenzimeve. Koncesionari nuk do të jetë i detyruar që të përballojë kosto shtesë, për ndryshimet që duhen bërë për të vepruar në përputhje me standartet e detyrueshme të hyra në fuqi pas Datës së Ekzekutimit, përveçse kur për kosto të ulla është rënë dakord në përputhje me Procedurën e Ndryshimeve të Kontratës.

13.6 Financimi i Koncesionit

13.6.1 Koncesionari do të sigurojë financim të përshtatshëm nga Palë Financuese të besueshme, për realizimin e Projektit sipas kësaj Kontrate, brenda 18 muajve nga Data Efektive.

13.6.2 Në zbatim të paragrafit 13.6.1, Koncesionari ka të drejtë të vendosi hipotekë,

peng, apo ndonjë barrë tjetër mbi asetet që ai (konçesionari) do të krijoj në zbatim të projektit të punimeve si dhe të lidhë çdo lloj marrëveshje financimi me çdo Palë Financuese, me kusht që hipoteka, pengu apo barra tjetër si dhe marrëveshja përkatëse e financimit t'i shërbejë përmbushjes së detyrimeve të Konçesionarit në këtë Kontrate.

14. Rregullimi

Palët bien dakord që të menaxhojnë këtë Kontrate përmes dispozitave të percaktuara në Aneksin 2 dhe 3 të kësaj kontrate siç mund të përcaktohen apo të bihen dakord me tej nga Palët.

15. Nën-kontraktimi

15.1 Konçesionari mund të nënkontrakttojë detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate. Për mënjanimin e ndonjë keqkuptimi furnizuesit e pajisjeve, materialeve dhe/ose dërgesave nuk do të konsiderohen nën-kontraktore sipas kësaj Kontrate.

15.2 Kontratat me nënkontraktuesit do të hartohen duke respektuar kushtet e vendosura në Aneksin 13 të kësaj kontrate (kushtet standarte të nënkontraktimit).

15.3 Konçesionari do të njoftojë Autoritetin për Nën-kontraktuesin me informacionin e mëposhtëm:

15.3.1 Emrin e tij, Eksperiencën dhe adresën;

15.3.2 Qëllimet për të cilat nën-kontraktuesi i propozuar do të kontraktohet, duke përfshirë çdo shërbim që do të ofrohet nga nën-kontraktuesi i propozuar; dhe

15.3.3 Vlerën e nënkontratës

15.4 Konçesionari është përgjegjës përpara Autoritetit, për përmbushjen e detyrimeve nga ana e nënkontraktuesit.


16. Rishikimi i Projektit dhe Shërbimeve

Në çdo kohe, secila Palë ka të drejte të kërkojë nga pala tjetër që të hyjë në diskutime në lidhje me rishikimin e Shërbimeve dhe gjithë ndryshimet e rena dakord do të zbatohen nga Palët.

17. Kontrolllet

17.1 Autoriteti mund të kryejë kontrolle një herë në vit, për realizimin e projektit. Kontrolli do të kryhet nga struktura të caktuara nga utullari i Autoritetit, me njoftimin paraprak të Konçesionarit.

17.2 Autoriteti do të bëjë përpjekjet e tij të arsyeshme për të siguruar që kryerja e secilit kontroll nuk e ndërpret në mënyre të pa-arsyeshme punën e Konçesionarit ose të shkaktojë vonesa në realizimin e projektit.



17.3 Kushtëzuar nga detyrimet e Autoritetit për konfidencialitet, Konçesionari do të sigurojë Autoritetit (dhe/ose përfaqësuesve të tij) të gjithë bashkëpunimin e arsyeshëm dhe ndihmën lidhur me çdo kontroll, duke përfshirë:

17.3.1 të gjithë informacionin e kërkuar nga Autoriteti brenda qëllimit të lejuar të kontrollit;

17.3.2 mundësi hyrje në çdo Zone të kontrolluar nga Konçesionari;

17.3.3 mundësi hyrje në ambientet e zbatimit të Projektit; dhe

17.4 Për qëllimet e kontrollit, Autoriteti duhet të njoftoje paraprakisht Konçesionarin të pakten 14 ditë pune, në lidhje me objektin e kontrollit.

17.5 Shpenzimet e kryera për qëllime të kontrollit do të perballohen nga Autoriteti.

17.6 Në qofte se një kontroll identifikon që Konçesionari nuk ka plotësuar një pjesë të detyrimeve të tij sipas kësaj kontrate, palet do të bien dakord dhe do të zbatojnë një plan korrigjimi. Autoriteti do të mbështesë Konçesionarin në zbatimin e planit të korrigjimit. Kur është e aplikueshme do të zbatohen penalitetet e parashikuara në Aneksin 4.

18. Regjistra dhe Raporte

Palet do të veprojnë në përputhje me dispozitat e Aneksit 2 (Kërkesat e Autoritetit) dhe 3 (Oferta e Konçesionarit) dhe me praktikën ligjore të fushave perkatëse, lidhur me mbajtjen e të dhënave dhe berjen e raporteve. Ato kanë detyrimin t'u japin njëra-tjetres informacionin që u kërkohe në lidhje me veprimtarinë, objekt i kontratës koncesionare.

19. Garancitë

19.1 Ligji, rregullore, urdhera apo procedura të miratuara pas hyrjes në fuqi të kësaj kontrate të cilat kanë fuqi në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe ndikojnë ose kufizojnë të drejtat ekskluzive të koncesionarit janë të zbatueshme deri në atë masë sa të mos ndikojnë në të drejtat e përcaktuara në këtë kontratë.

19.2 Në asnjë rast ligjet, rregulloret, urdhërat apo procedura të miratuara pas hyrjes në fuqi të kësaj kontrate, nuk do të cenojnë periudhën koncesionare të parashikuar në nenin 3.2 të kësaj kontrate, i cili pas hyrjes në fuqi të kësaj kontrate nuk do të jetë objekt ndryshimi.

20. Punësimi

20.1 Konçesionari do të sigurojë personel të mjaftueshëm në mënyrë që të plotësojë kërkesat e përcaktuara në këtë Kontratë. Konçesionari do të bëjë përpjekje për të nxitur punësimin në zonat përreth ku shtrihet projekti.

20.2 Konçesionari do të bëjë përpjekjet e tij me të mira për të siguruar mbajtjen e personelit të kualifikuar në nivel drejtuesish dhe të sigurojë që çdo zëvendësues do të jetë i kualifikuar dhe me përvojën e pershtatshme dhe teresisht kompetent për të zbatuar detyrat e caktuara të personit të cilin ai/ajo ka zëvendësuar.

21. Detyrime të Autoritetit

21.1 Përveçse kur është parashikuar ndryshe në këtë Kontrate, Autoriteti merr përsipër edhe detyrimet e mëposhtme:

21.1.1 Të sigurojë vazhdimësinë e kontratës, pavarësisht ndryshimeve të objektivave strategjike kombëtare dhe politikave makro-ekonomike të qeverisë dhe legjislacionit të sektorit të bujqësisë.

21.1.2 T'i sigurojë Koncesionarit të dhëna dhe informacion të rëndësishëm për përmbushjen e detyrimeve të tij në këtë Kontrate, dhe/ose të dhëna e informacion që kërkohen për menaxhimin, operimin dhe zhvillimin e Projektit (gjithmone nëse Autoriteti disponon këto të dhëna apo informacione), dhe të informojë Koncesionarin për çdo ngjarje në lidhje me objektin e koncesionit, dhe t'i dorëzojë Koncesionarit kopje të kësaj informacioni dhe të të dhënave.

21.1.3 Të sigurojë që Koncesionarit t'i jepet, pa pagese ose detyrim financiar të gjitha të drejtat e kalimit, servituit dhe lehtësira të tjera të kërkuara në pronë shtetërore nga Koncesionari për të zbatuar detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate (për të shmangur ndonjë dyshim, asnjë kompensim ose pagese nuk do të kryhet nga Koncesionari sipas Ligjit të Zbatueshëm për pronaret e tokës ose të pasuesve të tyre, ose të ndonjë Enti tjetër Shtetëror) sipas ligjit në fuqi në kohën e lidhjes së kontratës apo çdo ligji tjetër që hyn në fuqi pas dates efektive, nëse konsiderohet si i favorshëm për Koncesionarin. Nëse Koncesionari i lind nevoja e fitimit të të drejtave të kalimit, lehtësirave dhe të drejtave reale të tjera mbi pasuri të paluajtshme në pronë private për realizimin e projektit, Koncesionari ka të drejtë t'i kërkojë Autoritetit nisjen e procedurave të shpronësimit, dhe ky i fundit detyrohet të nisë procedurat e shpronësimit me shpenzimet e Koncesionarit. Shpronësimet, për efekt të kalimit, lehtësirave dhe/ose servituteve në pronë private, do të paraqiten paraprakisht nga Koncesionari në Projektin Perfundimtar, dhe do të behen të detyrueshme për Autoritetin nëse ky i fundit e miraton atë.

21.1.4 Në rast se si rezultat i veprimeve dhe/apo mosveprimeve të Autoritetit në përmbushjen e parashikimeve të nenit 21.1.3, Koncesionari peson dëm në mbarevajtjen e zbatimit të Projektit, atëherë ky i fundit ka të drejtë të kërkojë mbulimin e të gjithë shpenzimeve shtese të kryera si dhe shlyerjen e dëmeve të shkaktuara.

21.1.5 Të perkrahe dhe asistojë Koncesionarin duke marrë të gjitha masat e nevojshme nëse ndonjë Ent Shtetëror me veprimet dhe/ose mosveprimet e tij shkakton ose mendohet që mund të shkaktojë pengesa dhe/ose ndërhyje në zbatimin e

Projektit, operimet efciente te Projektit ose te permbushjes nga Koncesionari te kushteve te kesaj Kontrate, përfshirë ushtrimin nga Koncesionari te te drejtave te transferimit te fondeve dhe pagesave pa kufizime dhe pa vonesa, ne perputhje me Ligjin e Zbatueshem.

21.1.6 Te zbatoje detyrimet e tij ne perputhje me Nenin 3.5 ne lidhje me marrjen e licensave, lejeve dhe autorizimeve qe do t'i shërbejnë Koncesionarit për ushtrimin e te drejtave dhe ekzekutimin e detyrimeve ne zbatimin e kesaj Kontrate;

21.1.7 Te bëjë cdo përpjekje për te siguruar lidhjen e marrëveshjeve/kontratave të Koncesionarit me institucione publike per qellime te realizimit te objektit te kesaj kontrate, sic mund te jete aneksi ne shtrirjen e linjes se trasmetimit te ujit, linjes perpunuese teknologjike, etj.

21.1.8 Te marrë përsipër detyrimin të mos-licensojë ai vetë apo ente të tjera shtetërore në vartësi ose autoritetin e tij, aktivitete ne vendin ose ne zonen perreth vendit ku do te zhvillohet kultivimi i ullirit, qe mund te dëmtojnë ne menyre te drejteperdrejte ose te terthorte aktivitetin e Koncesionarit te përcaktuar në këtë Kontratë. Në vijim Autoriteti do të bëjë cdo përpjekje për te siguruar qe asnjë ent tjetër shtetëror të mos-licensojë ai vetë apo ente të tjera shtetërore në vartësi ose autoritetin e tij, aktivitete ne vendin ose ne zonen perreth vendit ku do te zhvillohet kultivimi i ullirit, qe mund te dëmtojnë ne menyre te drejteperdrejte ose te terthorte aktivitetin e Koncesionarit te përcaktuar në këtë kontratë.

21.1.9 Te sigurojë se:

- (i) sipërfaqja e tokës së dhënë në koncesion nuk do te përfshihet si e tille ne çdo plan urbanistik të ndryshëm nga ai qe mund të nevojitet për objektin e koncesionit, dhe
- (ii) nuk do t'i jepet asnjë autorizim asnjë pale te trete për te përdorur, ndërtuar ose konstruktuar ne sipërfaqen e tokës së dhënë në koncesion ne kundërshtim me te drejtat e Koncesionarit ne këtë Kontrate; Cdo autorizim, leje apo license qe mund te jepet ne kundërshtim te kesaj dispozite, konsiderohet i pavlefshem.
- (iii) sipërfaqja e tokës të dhënë me koncesion si dhe të gjitha të drejtat reale të tjera të përcaktuara në këtë kontratë si dhe kontrata vetë, janë objekt i regjistrimit në Zyrën perkatese te Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në emër të Shoqërisë Koncesionare. Gjithashtu do të regjistrohen në emër të Shoqërisë Koncesionare, të gjitha pasuritë e paluajtshme qe do të

krijohen mbi token e dhënë me koncension. Aplikimi per regjistrim ne Zyrën perkatese te Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme do te behet 30 dite pas dorezimit te siperfaqes se tokes, nga Autoriteti tek Koncesionari me gjithe dokumentacionin shoqerues te pronesisë.

21.2 Autoriteti është përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe kontraktore. Në rast të mospërmbushjes së këtyre detyrimeve nga ana e tij, do të shperblejë të gjitha dëmet e shkaktuara ndaj Koncesionarit dhe që kane të bejne me Kthimin e Vleres së Investimit të kryer (vlera e asetëve në momentin zgjidhjes së kontrates), sigurimin e kontrates (nëse ka) dhe shperblimin e dëmit për shkak të shkeljes së Kushteve të percaktuara në kontraten e koncesionit.

21.3 Autoriteti garanton se te gjitha te dhenat e tij te vena ne dispozicion te koncesionarit duke perfshire dhe Dokumentet e Procedures Konkuroese , jane te sakta, te verteta dhe pa gabime.

21.4 Rastet e Mospërmbushjes nga Autoriteti

Secili nga rastet si vijojnë përbejnë rastet e mospërmbushjes se detyrimeve nga Autoriteti ("Rast i Mospërmbushjes nga Autoriteti"), përjashtuar rastet kur ky Rast Mospërmbushje nga Autoriteti, ndodh si rrjedhoje e një Rasti Mospërmbushje te Koncesionarit ose për shkak te një Rasti te Forcës Madhore:

- (i) Autoriteti apo cdo Ent Shtetëror nuk përmbush ndonjë nga detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate dhe njëkohësisht nuk e ndreq këtë mospërmbushje brenda afatit përkatës te ndreqjes te caktuar ne këtë Kontrate për një rast specifik, dhe nëse nuk behet fjale për këtë rast, pas afatit te caktuar për ndreqje nga Autoriteti apo Enti Shtetëror me kusht qe ky afat mos te jete me pak se 40 (dyzet) dite pune, ose
- (ii) Autoriteti nuk e njeh këtë Kontrate ose ne një mënyrë tjetër te te kuptoje qëllimin e saj për te mos qene me e detyruar sipas kësaj Kontrate; ose
- (iii) Autoriteti apo çdo Ent Shtetëror, si rrjedhoje e veprimeve apo mosveprimeve te tyre si dhe atehere kur duhet, sipas kësaj Kontrate, krijojnë rrethana te tilla qe nuk lejojnë Koncesionarit të përmbushë detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate dhe nuk e ndreqin këtë mospërmbushje brenda 3 ditëve pas mbarimit te periudhës se ndreqjes te lajmëruar nga Koncesionari, ne përputhje me pikën (a) si me sipër; ose
- (iv) Autoriteti vonon pagesën e çdo shume te detyruar dhe te kërkueshme nga Koncesionari sipas Nenit 7.3; ose
- (v) Çdo deklaram i bere ose garanci e dhënë nga Autoriteti në këtë Kontrate zbulohet qe është fals, i pasaktë ose i pavërtet.

22. Të drejtat dhe Detyrimet e Konçesionarit

Përveç sa është parashikuar në këtë kontratë, Koncesionari ka edhe këto të drejta e detyrime:

22.1 Të Drejtat e Konçesionarit

Përveç të drejtave që lindin nga dhënia e Konçesionit, Konçesionari gëzon të drejtat e mëposhtme:

22.1.1 Të ushtroje të gjitha të drejtat në lidhje me përdorimin ekskluziv të sipërfaqes së pronës, sipas përshkrimit në Aneksin 12 të kësaj Kontrate si dhe të ketë të drejtën e servitutit në pronat fqinjë sipas përcaktimit të bërë në nenin 21.1.3, nëse kjo do t'i shërbejë për të ushtruar aktivitetin e tij në kuptim të kësaj kontrate;

22.1.2 Të punesoje apo angazhoje punonjes, me qëllim zbatimin e Konçesionit si dhe të hartojë politiken e vetë të punësimit në përputhje me ligjet në fuqi dhe këtë Kontratë;

22.1.3 Të kryejë veprime të tjera që i konsideron të nevojshme për të përmbushur detyrimet dhe të ushtroje të drejtat e tij sipas kësaj Kontrate;

22.1.4 Të kërkojë zgjatjen e Periudhës së Konçesionit në përputhje me parashikimet e kësaj Kontrate.

22.2 Detyrime të Përgjithshme të Konçesionarit

22.2.1 Të zbatojë Projektin e Konçesionit në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate dhe Aneksit e saj;

22.2.2 Përveç rasteve kur shprehet ndryshe në këtë Kontratë ose kur është rënë dakord ndryshe me Palëve, Koncesionari do të aplikojë dhe paguajë, marrë dhe ruajë me mbështetje të Autoritetit, të gjitha autorizimet, lejet dhe licencat e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kësaj Kontrate.

22.2.3 Konçesionari do të caktojë, mbikqyrë, monitorojë dhe kontrollojë aktivitetet e nenkontraktorit (sipas kontratave perkatese që mund të jenë të nevojshme) në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate dhe Aneksit e saj;

22.3 Koncesionari detyrohet të zbatojë piken (iii), Neni 21.1.9.

22.4 Pas përfundimit të Periudhës së Konçesionit, në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate, pasuritë/asetet e krijuara vetëm nga Shoqëria Koncesionare gjatë aktivitetit të saj, do të kalohen Autoritetit pa kundërshtim.

22.5 Detyrime të Posaçme të Konçesionarit

Konçesionari është i detyruar:

22.5.1 Të krijojë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data efektive të kësaj Kontrate Shoqërinë Koncesionare, e cila do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj realizimin

e Projektit të Konçesionit, në përputhje me kushtet dhe dispozitat e kësaj Kontrate;

22.5.2 Shoqëria e krijuar do t'i nënshtrohet të gjitha dispozitave ligjore, që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare në Shqipëri.

Në mënyrë të veçante kërkohet që statuti i Shoqërisë Konçesionare të përmbajë të pakten:

- (i) Forma e shoqërisë: Forma e shoqërisë do të jetë “shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” ose “shoqëri anonime”, duke funksionuar në zbatim të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”;
- (ii) Objekti i shoqërisë: Projektimi, Ndërtimi, Vënia në shfrytëzim, Administrimi, Mirëmbajtja e Masivit të Ullishtes dhe tregtimi i ullirit.
- (iii) Kohezgjatja: Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me afatin e kësaj Kontrate Konçesionare;

22.5.3 Konçesionari dhe Shoqëria Konçesionare, do të jenë individualisht dhe solidarisht përgjegjës për detyrimet që rrjedhin nga kjo Kontratë, për një periudhë prej 20 (njzet) vjetësh nga data efektive e kësaj kontrate. Me kalimin e këtij afati përgjegjësia për të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kjo kontratë i mbetet vetëm Shoqërisë Konçesionare, pa prekur të drejtat e Konçesionarit në këtë kontratë.

22.5.4 Të realizojë prodhimin mesatar vjetor 10 ton/ha.

22.5.5 Të sigurojë cilësi të lartë, besueshmëri dhe qëndrueshmëri të projektit gjatë periudhës së Konçesionit;

22.5.6 Të informojë Autoritetin në çfarëdo rrethane që mund të demtojë procesin e zbatimit të Konçesionit;

22.5.7 Të përdori teknologji të përshtatshme për zbatimin e projektit që mos të demtojë Tokën objekt të projektit dhe ato përreth saj.

22.5.8 Të raportojë çdo 6 muaj tek Autoriteti në lidhje me ecurinë e Konçesionit, siç percaktohet në këtë Kontratë;

22.5.9 Të marrë të gjitha masat e duhura dhe të nevojshme me qëllim garantimin e kushteve të sigurisë në punë për punonjësit e tij si dhe të njohë dhe zbatojë legjislacionin që lidhet me parandalimin e dëmeve dhe fatkeqesive.

22.5.10. Të marrë masa për të garantuar mbrojtjen e mjedisit gjatë gjithë periudhës së konçesionit;

22.5.11 Të përballojë të gjitha shpenzimet që lidhen me dëmet që eventalisht mund t'i shkaktohen palëve të treta, për faj të tij.

22.5.12 Persa i perket shfrytezimit te siperfaqes se Masivit te Ullishtes, Koncesionari eshte i detyruar te respektojë kalimin e te tretteve pa asnje kufizim, ne ato rruge kalimi publike qe ekzistojne para dates se hyrjes ne fuqi te kesaj Kontrate. Per kete qellim, ne paraqitjen e Projektit Perfundimtar nga Koncesionari prane Autoritetit Kontraktor, duhet te saktesohen rruget e kalimit, siperfaqja e tyre (nese eshte e mundur), duke u pasqyruar ne hartat perkatese. Siperfaqja qe zene keto rruge kalimi, nuk do te konsiderohet si pjese e siperfaqes se dhene me Koncesion tek Koncesionari.

22.6 Rastet e Mospërbushjes nga Koncesionari

Secili prej rasteve që vijon përbën rastin e mospërbushje nga Koncesionari (Rastet e Mospërbushjes nga Koncesionari), përveç kur Rasti i Mospërbushjes nga Koncesionari vjen për shkak të Rastit të Forcës Madhore :

- (i) Koncesionari nuk ka përbushur ndonjë prej detyrimeve të saj në afatin e duhur sipas Kontratës dhe nuk ka arritur që brenda afatit përkatës të korrigjimit të caktuar në këtë Kontratë për një rast specifik, ose kur nuk behet fjale për këtë rast, brenda afatit të korrigjimit të njoftuar Koncesionarit nga Autoriteti, të ndreqe këtë mospërbushje.
- (ii) Çdo deklaram i bere ose garanci e dhënë nga Koncesionari, sipas kësaj Kontrate zbulohet të jete fals ose i pasaktë.
- (iii) Koncesionari ndodhet para Rastit të Paafësisë Paguese
- (iv) Koncesionari nuk e njeh këtë Kontratë ose në një mënyrë tjetër lë të kuptojë qëllimin e saj për të mos qene me e detyruar sipas kësaj Kontrate.

23. Forca Madhore

23.1 Me Ngjarje të Forces Madhore nënkuptohen ato rrethana sipas përkufizimit të Ngjarjes), të cilat janë jashtë kontrollit të mundshëm të palëve si p.sh ndryshime klimatike të paparashikuara, dhe nuk ndodhin për faj të tyre, dhe që ndikojnë në objektin e kësaj Kontrate, duke bërë të pamundur përbushjen e detyrimeve të Palës së dëmtuar, por me kusht që:

- (i) ngjarje të tilla nuk mund të parashikoheshin apo shmangeshin, pavarësisht kujdesit të arsyeshëm të treguar nga pala e dëmtuar;
- (ii) pala e dëmtuar mori ose kishte marrë të gjitha masat paraprake të arsyeshme, për të shmangur pasojat e kësaj ngjarjeje, që solli si pasojë paafësinë e kësaj pale për të përbushur detyrimet e Kontratës;
- (iii) ngjarja nuk është ose nuk ishte, drejtpërsëdrejti ose jo, rezultat i ndonjë mospërbushje detyrimesh të parashikuar në këtë Kontratë;

- 23.2 Në rastet e Forces Madhore pala e dëmtuar duhet të njoftoje palën tjetër brenda 10 dhjete) ditëve pune, duke i treguar dhe arsyetuar shtyrjen e përmbushjes së detyrimeve në menyre që të gjejnë një rrugë për të lehtësuar efektet e forcës madhore dhe të vazhdojnë kontratën.
- 23.3 **Pasoja e Ngjarjeve të Forcës Madhore**
Në rastin e ndodhjes së çfarëdo Ngjarje të Forces Madhore, do të zbatohen sa vijon:
- 23.3.1 Koncesionari, nuk do të konsiderohet ne vonese, dhe nuk do të aplikohen penalitete ndaj tij;
- 23.3.2 në rastin kur një Ngjarje e Forcës Madhore ndodh përpara Datës Efektive, afati për arritjen e Datës Efektive do të shtrihet me periudhën për të cilën Ngjarja e Forcës Madhore do të vazhdojë;
- 23.3.3 në rastin kur një Ngjarje e Forces Madhore ndodh pas Datës Efektive, Periudha e Koncesionit do të zgjatët në përputhje me nenin 3.3.5 të kesaj kontrate;
- 24 **Dëmspërblimi**
- 24.1 Koncesionari do të jete përgjegjës për shpërblimin e demit ndaj Autoriteti dhe/ose cdo Enti Shtetëror qe vjen si rezultat ose pasojë e mospërmbushjes nga ana e tij, me kushtë që kjo shkelje te mos jete shkaktuar ne mënyrë te drejtpërdrejtë apo të tërthortë nga një Ndryshim ne Ligj.
- 24.2 Autoriteti dhe/ose cdo Enti Shtetëror do të jete përgjegjës për shpërblimin e demit ndaj Koncesionarit qe vjen si rezultat ose pasojë e mospërmbushjes nga ana e tij, me kushtë që kjo shkelje te mos jete shkaktuar ne mënyrë te drejtpërdrejtë apo të tërthortë nga një Ndryshim ne Ligj.
- 24.3 Shpërblimi i demit mund të kërkohet sipas rastit nga Koncesionari ose Autoriteti, pa cënuar ushtrimin e të drejtave të tjera në këtë kontratë.
- 24.4 Ne te gjitha rastet pala qe vendos ose pretendon te drejtën për t'iu shpërblyer dëmi ne përputhje me këtë Kontrate do te këtë detyrimin te marre te gjitha masat për te pakesuar efektet e demit te ndodhur, duke marre parasysh se ajo mund ta beje këtë pa shkaktuar shpenzime te paarsyeshme.
25. **Konfidencialiteti**
- 25.1 Secila nga palët duhet të konsideroje si konfidenciale të gjitha dokumentat dhe informacionet e tjera në lidhje me projektin, qofshin keto tregtare, teknike, juridike dhe nuk duhet t'ja bëjë të ditura një palë të trete, të gjithë apo një pjesë të dokumentit apo informacionit, pa miratimin e palës tjetër, perveçse për qëllimin e përmbushjes së kushteve të kesaj kontrate.
- 25.2 Dispozita 25.1, nuk do të zbatohet në shkallen që:

- 25.2.1 Ky informacion ka qene në zoterim të Palës që bën zbulimin pa detyrimin e konfidencialitetit para zbulimit të tij nga zoteruesi i informacionit;
- 25.2.2 Ky informacion ishte përftuar nga një palë e tretë pa detyrimin e konfidencialitetit;
- 25.2.3 Ky informacion ka qenë për përdorim publik në kohën e zbulimit ndryshe nga shkelja e kësaj Kontrate; ose
- 25.2.4 Një informacion i tillë është i detyrueshëm për tu nxjerrë sipas ligjit.

25.3 Asgjë në këtë Kontrate nuk do e pengojë Autoritetin të zbulojë Informacionin Konfidencial të Konçesionarit:

- 25.3.1 Ndaj cilitdo entit qeveritar. Të gjitha entet qeveritare që marrin këtë Informacion Konfidencial do të kenë të drejtë t'ia japin më tej Informacionin Konfidencial departamenteve të tjera qeveritare, mbi bazën që informacioni të jetë konfidencial dhe të mos i zbulohet një palë të tretë që nuk është pjesë e departamentit qeveritar ose e një Autoriteti.
- 25.3.2 Mbi bazën e “nevojës për njohuri” nga konsulenti, kontraktori ose ndonjë person tjetër të angazhuar nga Autoriteti me kusht që një person i tillë të bjerë dakord që ta ruaje këtë informacion si konfidencial;

26. Kufijtë e penaliteteve

- 26.1** Kufijtë e penaliteteve që duhet të paguajë Konçesionari për moszbatim të detyrimeve në përputhje me afatet dhe mënyrën e rënë dakort në këtë Kontratë dhe në Aneksat e saj, do të jenë ato të parashikuara në Aneksin 4. Pagimi i çfarëdo lloj penaliteti nuk do të zhveshë konçesionarin nga përgjegjësia për të ekzekutuar detyrimin.

27. Sigurimi

Gjate gjithë kohezgjatjes së Kontrates, me qëllim garantimin e një aktiviteti të pandërprerë Konçesionari duhet të bëjë sigurimin e aseteve të krijuara sipas vlerës së investimit të realizuar në vite, nga çdo ngjarje, rrethane apo Force Majeure, brenda kufijve të përgjegjësisë që mbulohen me sigurim, jo me pak se 70% të vlerës së investuar. Për këtë qëllim, Shoqëria Koncesionare do të paraqesë çdo vit pranë Autoritetit dokumentin perkates që verteton sigurimin, leshuar nga institucioni perkates.

28. Deklarime

28.1 Autoriteti

Autoriteti deklaron dhe garanton se, që nga data e kësaj Kontrate dhe gjatë Periudhës së Konçesionit:

- 28.1.1 Ai ka fuqinë dhe autoritetin e plotë për të ekzekutuar, realizuar dhe përmbushur detyrimet sipas kësaj Kontrate;

28.1.2 Kjo Kontrate përbën detyrimin e tij ligjor, të vlefshëm dhe ligjrisht detyrues që parashikohet në përputhje me kushtet e saj;

28.1.3 Konçesionari do të marrë në dorëzim objektin fizik të konçesionit të lirë nga çdo pretendim pronësie apo barrë brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga data Efektive e kontratës. Ai do të zotëroj paqësisht (posedimin si pronë) tokën dhe asetet e Konçesionit. Përgjegjës përpara të treta në rast të pretendimeve për detyrime apo të drejta pronësie ose reale të tyre mbi tokën dhe asetet e projektit, do të jetë Autoriteti i cili ruan të drejten e pronësisë së tokës gjatë gjithë Periudhës së Konçesionit;

28.1.4 Ekzekutimi, realizimi dhe përmbushja e kësaj Kontrate nuk do të krijojë konflikte, nuk do të rezultojë në shkelje dhe nuk do të përbëjë kundërvajtje apo të përshejtojë realizimin që kërkohet nga çfarëdo kushti i ligjeve në fuqi apo Kontrateve, konventave, dekreteve apo urdhrave tek të cilat ai është palë apo nga të cilat ai ose cilado pronë apo aset mund të ndikohen ose mbartin detyrim.

28.2 Konçesionari

Konçesionari deklaron dhe garanton tek Autoriteti se, që nga data e ekzekutimit të kësaj Kontrate dhe gjatë Periudhës së Konçesionit:

28.2.1 Ka fuqinë dhe autoritetin e plotë për të ekzekutuar, realizuar dhe përmbushur detyrimet nën këtë kontrate dhe për të kryer transaksionet e parashikuara në të;

29.2.2 Ka aftësinë dhe kapacitetin financiar për të ndërmarrë Konçesionin;

29.2.3 Do të përmbushë detyrimet e tij me profesionalizëm;

29. Zgjidhja e Kontratës

29.1 Autoritetit, në rast se nuk është parashikuar në këtë Kontrate, i jepet e drejta për të zgjidhur këtë Kontrate kur:

29.1.1 Konçesionari dështon në sigurimin e financimit të projektit brenda 18 muajve nga Data Efektive.

29.1.2 Konçesionari është në shkelje të elementeve të tjera thelbësore të Projektit Perfundimtar.

29.1.3 Konçesionari dhe Shoqëria Konçesionare transferojnë të drejtat dhe detyrimet e marra përsipër me këtë Kontrate, pa miratim të Autoritetit siç parashikohet në nenin 32 të kësaj Kontrate.

29.1.4 Konçesionari me veprimet ose mosveprimet e tij të kryera me dashje ose nga pakujdesia, ka krijuar rrethana që kanë sjellë si pasojë mosrealizim më shumë se 25 % të prodhimit të parashikuar vjetor, pas 11 (vjetësh) vjetësh nga marrja e Certifikatës së Pranimit.

29.1.5 Koncesionari me veprimet ose mosveprimet e tij te kryera me dashje ose nga pakujdesia, shkakton shkelje serioze. Te tilla shkelje do te konsiderohen edhe:

- (i) Mosrealizimi i ngritjes se masivit te ullirit ne masen 20% ne perfundim te afatit 7 vjecar;
- (ii) Mosrealizimi i vleres se investimit ne masen 20% per hektare;
- (iii) Mosrealizimi i vleres se riinvestimit ne masen 20% per cdo kriter (kriteret e perdorura jane ullahtja dhe teknologjia e perdorur).

29.1.6 Zgjidhja e Kontrates e parashikuar ne paragrafet 29.1.4 dhe 29.1.5, mund te kerkohet nga Autoriteti vetem pas kalimit te nje afati 1 (nje) vjecar nga koha e fillimit te shkeljes. Per periudhen 1 vjecare do te aplikohen penalitetet sipas Aneksit 4.

29.2 Koncesionari, pervec ushtrimit te drejtave te tjera ne kontrate, ka te drejte te zgjidhe kete Kontrate kur Autoriteti me veprimet ose mosveprimet e tij te kryera me dashje ose nga pakujdesia, shkakton shkelje serioze. Te tilla shkelje do te konsiderohen :

- (i) Mosdorezimi ne afat e percaktuar ne kete Kontrate te siperfaqes se tokes te dhene me Koncesion;
- (ii) Mospajisja ose pajisja me vonese me Autorizime, Leje dhe/ose Licensa te nevojshme per zbatimin e Kontrates, per nje periudhe 1 (nje vjecare) me kushtin qe mospajisja ose pajisja me vonese te jete pengese serioze ne realizimin e Projektit;
- (iii) Autoriteti eshte ne shkelje te elementeve te tjere thelbësore te Projektit Perfundimtar te kesaj Kontrate.

29.3 Nëse kontrata zgjidhet nga Autoriteti në zbatim të pikës 29.1, Koncesionari ka të drejtën të kërkojë nga Autoriteti vetem kompensimin e plotë të vlerës së kredise/kredive të pashlyera në momentin e zgjidhjes konform kushteve të kontratës së kredisë, të marra për realizimin e koncesionit nga Koncesionari ose Shoqëria Koncesionare (kur zgjidhja behet per efekt te nenit 29.1.1, nuk aplikohet ky parashikim). Per efekt te kompensimit te vleres se kredive te pashlyera, Koncesionari deklaron qe:

- (i) Vlera e kredise/kredive qe do te marre per financimin e projektit nuk do te jete me shume se 80% e vleres se investimit prej 15.5 (pesembedhjete pike pese) milion Euro;
- (ii) Shlyerja e kredise/kredive do te behet brenda nje periudhe 18 (terembedhjete) vjecare nga dita e levrimit te pare te cdo kredie.

Ne çdo rast, Autoriteti nuk do të shlyejë shumën e kesteve të papaguara në kohë, në momentin e zgjidhjes së Kontrates. Përdorimi i burimeve financiare në formën e kredise/kredive për financimin e Projektit do të jetë subjekt monitorimi nga Autoriteti.

- 29.4 Nëse Kontrata zgjidhet pa asnjë shkak nga Autoriteti, Koncesionari ka të drejtën të kërkojë nga Autoriteti kompensimin e plotë të vlerës së investimit të kryer prej tij si dhe gjithë demin e shkaktuar. Autoriteti detyrohet t'i paguajë Koncesionarit një kusht penal të barabartë me vlerën e investimit të realizuar, përveç demit të shkaktuar.

29.5 Përfundimi i Kontratës për shkak të Forces Madhore

29.5.1 Nëse një ngjarje e Forces Madhore vazhdon ose me gjykimin e drejte të Palëve, ka mundësi të vazhdojë për një periudhë me të gjatë së 2 (dy) të njëpasnjëshëm, secila Palë mund të përfundojë këtë Kontratë, duke i dhënë një Njoftim Përfundimi Palës tjetër. Nëse kontrata zgjidhet si pasojë e Forcës Madhore, Shoqëria Koncesionare ka të drejtë të kërkojë nga Autoriteti kompensimin e plotë të vlerës së asetëve të tij në momentin e zgjidhjes së kontratës, me kusht që asetet të ekzistojnë dhe të jenë funksionale.

29.6 Njoftimi i Përfundimit

29.6.1 Secila nga Palët që kërkon zgjidhjen e kësaj Kontrate në përputhje me Nenin 29, do të njoftojë paraprakisht me shkrim Palën tjetër (Njoftim Përfundimi). Njoftimi i Përfundimit duhet të përmbajë:

- (i) Detajet e duhura duke nënvizuar Ngjarjen e Shkakut;
- (ii) Datën e Përfundimit, e cila duhet të jetë jo më parë se 30 ditë nga data e Njoftimit të Përfundimit;
- (iii) Përfundimi i Pagesës, përfshirë dhe hollësitë e llogaritjes nga kjo dhe;
- (iv) Çdo informacion tjetër të rëndësishëm.

29.7 Zëvendësimi i Koncesionarit

Pavarësisht nga sa më sipër, Njoftimi i përfundimit konsiderohet të jetë tërhequr, nëse, para hyrjes së tij në fuqi, Koncesionari vendosë, në pajtim me Ligjin, të:

- (i) realizojnë një peng mbi Aksionet e Zakonshme; dhe/ose
- (ii) të propozojnë transferimin e Projektit tek një ekip zëvendës menaxherial ose një subjekt zëvendës për qëllimet e sigurimit të vazhdimësisë së Projektit.

Në lidhje me sa më sipër, Autoriteti Kontraktues:

- (i) nuk mban në mënyrë të paarsyeshme ose vonon pëlqimin e tij nëse ekipi i propozuar i menaxhimit ka ekspertizën, aftësitë, reputacionin dhe gjendjen financiare të paktën si ato të Koncesionarit, dhe

- (ii) kryen të gjitha veprimet që kërkohen ose janë të dobishme për të realizuar këtë transferim.

30. Pasojat të tjera të Përfundimit

30.1 Me njoftimin për përfundim të parakohshëm të Kontratës, Palët janë të detyruara të nisin procedurën e dorëzimit të mjediseve dhe infrastrukturës së Projektit, në përputhje me parashikimet e nenit 3.6 dhe 3.7 të kësaj Kontrate.

30.2 Mbarimi i Periudhës së Konçesionit, apo përfundimi i parakohshëm i kësaj Kontrate (sido që të ndodhe ai), nuk duhet të cenoje të drejtat apo ligjshmërinë e çdonjeres prej palëve, në këtë Kontrate e cila në mënyre të qarte apo të nenkuptuar, ka si qëllim të veproje edhe pas përfundimit apo mbarimit të saj (kësaj Kontrate) mbi parashikimet e dispozitave të nenit 25 (Konfidencialiteti), 24 (Dëmshpërblimi), 34 (Ndarja), 36 (Kontrata si një e tere) dhe 39 (Ligji rregullues dhe Arbitrazhi).

31. Sigurimi i Kontrates

31.1 Konçesionari, me shpenzimet e tij, do t'i siguroje Autoritetit një Sigurim Kontrate të lëshuar nga një institucion bankar apo shoqëri sigurimesh, që ushtron aktivitetin e saj, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për një shume të barabarte me 7 % të vlerës totale të investimit, sipas formes së përcaktuar në Aneksin 11 (Sigurimi i Kontrates).

31.2 Sigurimi i Kontrates do të shërbejë për të garantuar zbatimin e detyrimeve deri në përfundimin e investimit, në mënyrën dhe afatet e rëna dakort në këtë kontratë dhe/ose Aneksin e saj.

31.3 Autoriteti do të lëshojë Sigurimin e Kontrates për Konçesionarin pas kalimit të një periudhe prej 30 ditësh nga data e lëshimit ose nga data që duhet të ishte lëshuar Çertifikata e Pranimit sipas neni 6 të kontratës.

31.4 Sigurimi i Kontratës do të zbritet në përputhje me raportet vjetore të rakorduara ndërmjet palëve sipas planeve vjetore të paraqitura nga Konçesionari në zbatim të Neni 13.1.

Sigurimi i Kontratës do të zvogëlohet në përputhje me formulën në vijim:

- (i) 30% të vlerës së Sigurimit, brenda 30 ditëve nga përfundimi i vitit të parë;
- (ii) 20% të vlerës së Sigurimit, brenda 30 ditëve nga përfundimi i vitit të dytë;
- (iii) 10% të vlerës së Sigurimit, brenda 30 ditëve nga përfundimi i vitit të tretë;
- (iv) 10% të vlerës së Sigurimit, brenda 30 ditëve nga përfundimi i vitit të katërt;
- (v) 10% të vlerës së Sigurimit, brenda 30 ditëve nga përfundimi i vitit të pestë;
- (vi) 10% të vlerës së Sigurimit, brenda 30 ditëve nga përfundimi i vitit të gjashtë;
- (vii) 10% të vlerës së Sigurimit, brenda 30 ditëve nga përfundimi i vitit të shtatë.

Për sa kohë do të jetë i vlefshëm sigurimi i kontratës, penalitetet që do të zbatohen për mospërbushje të detyrimeve nga ana e Konçesionarit do të mbahen nga shuma e

sigurimit të kontratës. Koncesionari është i detyruar që brenda 15 ditëve të mbulojë këtë tërheqje në mënyrë që shuma e sigurimit të kontratës të mos bjerë nën vlerat e përcaktuara me sipër.

Pa cenuar asnjë të drejtë tjetër, Palët kanë të drejtë në çdo kohë të kompensojnë njera tjetren për detyrimet monetare të ndersjellta ndërmjet tyre.

32. Transferimi i Kontratës

~~32.1~~ Palët bien dakord se kjo Kontrate do t'i caktohet nga Koncesionari, Shoqërisë Koncesionare në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate. Për këtë qëllim, mbi bazën e rregjistrimit të Shoqërisë Koncesionare në Regjistrin Tregtar që mbahet nga Qendra Kombëtare e Rregjistrimit, Koncesionari do të njoftojë me shkrim në formë të shkruar Autoritetin.

32.2 Në lidhje me një gjë të tillë, Palët bien dakord së të gjitha të drejtat dhe/ose detyrimet e lidhura me këtë kontratë do të transferohen nga Koncesionari tek Shoqëria Koncesionare duke filluar që nga data e rregjistrimit të Shoqërisë Koncesionare në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit. Me zgjidhjen ose mbarimin e kontratës, pas dorezimit të masivitetit të ullishtes dhe asetëve të tjera në shërbim të projektit, të drejtat që mbeten si emri tregtar, etj., i transferohen Koncesionarit.

32.3 Përveç rastit të parashikuar në pikën 33.2 të këtij neni, Koncesionari dhe Shoqëria Koncesionare, nuk kanë të drejtë të transferojnë pjesërisht apo tërësisht të drejtat dhe detyrimet e marra përsipër me këtë kontratë, përveç së kur një transferim i tillë miratohet me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.

32.4 Koncesionari, me miratimin e Autoritetit Kontraktues ka të drejtë të transferojë kuota/aksione të kapitalit themeltar të Shoqërisë Koncesionare, personave të tretë. Koncesionari lejohet të transferojë brenda një periudhe 15 vjeçare (duke filluar nga Data Efektive) deri në 49% të kvotave/aksioneve të Shoqërisë Koncesionare. Me kalimin e këtij afati, nuk aplikohen kufizime të tjera. Miratimi për transferim të kvotave/aksioneve nuk do të refuzohet nga Autoriteti nëse personi/personat i/e tretë vërtetojnë se ushtrijne aktivitetin e tyre në fusha të njëjta me objektin e koncesionit, kanë eksperiencë të ngjashme, kapacitet financiar të besueshëm, dhe aftësi menaxhimi.

33. Marreveshja e Palëve

Asgjë në këtë Kontrate nuk ka për qëllim që të krijojë një ortakeri apo një marrëdhënie ligjore të çfarëdo lloji që mund të shtonte përgjegjësi mbi njërën Palë për veprimin apo mosveprimin e Palës tjetër apo që të autorizonte secilin nga Palët që të veprojë si agjente për Palën tjetër. Asnjë nga palët nuk do të këtë Autoritetin që të bëjë perfaqësime apo të veprojë në emër të Palës tjetër apo të angazhojë palën tjetër në çfarëdo mënyrë.

34. Ndarja

Nëse cilado nga dispozitat/nen e kesaj Kontrate vlerësohet si e pavlefshme, e paligjshme, e pazbatueshme për çfarëdo arsye dhe nga cilado gjykate apo juridiksion kompetent, një dispozitë/nen e tillë do të shfyqizohet pa sjellë pasoja për dispozitat që mbeten. Nëse një dispozitë/nen e kësaj Kontrate që është themelore për përmbushjen e qëllimit të kësaj Kontrate gjykohe të është e pavlefshme në çfarëdo shtrirje, Konçesionari dhe Autoriteti do të fillojnë menjëherë negociatat në mirëbesim për ta rregulluar këtë pavlefshmëri.

35. Ndryshimet e kontratës

Kjo kontratë mund të ndryshohet me marrëveshje të shkruar nga të dy palëve, në përputhje me aneksin 6 të kësaj Kontrate (Proçedura e Ndryshimeve të Kontratës).

Secila palë mund t'i drejtojë një Kërkesë për Ndryshim palës tjetër në çdo kohë gjatë Kohëzgjatjes së Kontratës.

Çdo ndryshim i kësaj kontrate apo anekseve bashkëlidhur saj, do të jetë pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj kontrate.

36. Kontrata si një e tërë

36.1 Kjo Kontrate, së bashku me dokumentat të cilave i bëhet referim në të, përbën Kontratën si një e tërë.

36.2 Kjo Kontratë do të hartohet në gjuhën shqipe ne 9(nente) kopje origjinale dhe të gjitha komunikimet dhe njoftimet ndërmjet Palëve në lidhje me të do të jenë në gjuhën shqipe.

37. Fosilet dhe Objektet Antike

Ne zbatim te pikes 9, Neni 3.1.2, Konçesionari do të njoftojë menjëherë Autoritetin ne rast te zbulimit te fosileve apo objekteve antike. Pas marrjes së njoftimit nga Konçesionari, Autoriteti Kontraktues do të informoje Autoritetet kompetente Shqiptare, të bashkerendojne kërkimet e fosileve ose objekteve antike në sheshin e ndertimit. Kosto e këtyre zbulimeve dhe te vonesave ne plotësimin e detyrimeve te palëve sipas kësaj Kontrate do te përballohen nga Enti Shteteror kompetent.

38. Njoftimet

38.1 Cilatdo njoftime, të dhëna sipas apo në lidhje me këtë Kontrate do të jenë me shkrim, të nënshkruara nga apo në emër të Palës që e bën njoftimin dhe do të njoftohet përmes dërgimit personalisht apo dërgimit me postë rekomande, në adresën e deklaruar nga Pala në këtë Kontratë. Njoftimet nuk do të dërgohen me postë elektronike (e-mail).

38.2 Çdo Kërkesë për Ndryshim do të jetë me shkrim dhe e nënshkruar.

38.3 Do të quhet se një njoftim është marrë:

38.3.1 Nëse është dërguar personalisht;

38.3.2 Nëse është dërguar me postë rekomande;

- 39. Ligji rregullues dhe Arbitrazhi**
- 39.1** Kjo Kontrate do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.
- 39.2** Cdo kundërshtim, mosmarrvëshje apo ankese midis paleve kontraktuese që lind ose ka lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj Kontrate Koncesioni, duke përfshirë, por jo vetëm, çështjet që kanë të bëjnë me përfundimin e saj, shkeljet, zgjidhjen, pavlefshmërinë-ose-efekter para dhe pas kontraktore, qofshin këto të përfshirë në këtë Kontratë apo instrumentë të tjerë ligjorë do të kalohet nga Palët e përfshira në këtë Mosmarrvëshje fillimisht tek zgjidhja me anë të marrvëshjes me mirëkuptim, duke përdorur Procesin e Shkallëzimit sipas aneksit 10, bazuar në vullnetin e mirë.
- 39.3** Vendimi i përbashkët dhe unanim i Autoritetit dhe Koncesionarit, apo përfaqësuesve të tyre do të jetë një vendim përfundimtar dhe i detyrueshëm për Palët .
- 39.4** Pala që dëshëron të fillojë Procesin e Shkallëzimit do t'i dërgojë një njoftim me shkrim palës tjetër. Nëse përfaqësuesi i Autoritetit dhe përfaqësuesi i Koncesionarit nuk takohen, ose, Mosmarrvëshja nuk zgjidhet brenda 1 muaji nga marrja e këtij njoftimi, cdo palë e Mosmarrvëshjes mund të kërkojë që Mosmarrvëshja të zgjidhet me arbitrazh në përputhje me Pikën 39.5 të kësaj Kontrate.
- 39.5 Arbitrazhi**
- 39.5.1** Kur me gjithë përpjekjet e paleve nuk arrihet në një konsensus i përbashkët, sipas Aneksit 10, cdo Mosmarrvëshje, në shkallë të fundit do të zgjidhet me Arbitrazh në përputhje me Rregullat e ICC-së të zbatueshme në kohën e nënshkrimit të kësaj Kontrate.
- 39.5.2** Numri i Arbitrave do të vendoset nga ana e Palëve në momentin kur të bëhet kërkesa për Arbitrim pranë Sekretariatit të ICC-së.
- 39.5.3** Vendi i zhvillimit të Arbitrazhit do të jetë Zvicra, Gjeneve.
- 39.5.4** Gjuha e arbitrazhit do të jetë gjuha angleze.
- 39.5.5** Shpenzimet e Arbitrazhit do të përcaktohen nga Trupa e Arbitrave/ Arbitri i Vetëm në vendimin përfundimtar.
- 39.5.6** Asgjë në këtë Kontratë nuk i pengon Palët që të kërkojnë nga gjykata e arbitrazhit kompetente të marrë vendime ose masa të përkohshme për çështje që kanë lidhje me këtë Kontratë, dhe për të cilat Palët kanë bërë kërkesa për "Masë sigurimi".
- 39.6** Fillimi apo vazhdimi i negociatave për zgjidhje me dialog, apo I procedurave të arbitrazhit nuk do të pezullojë zbatimin e projektit sipas objektit të kontratës dhe nuk do të çlirojë palët nga detyrimet e marra për sipër me anë të kësaj Kontrate.
- 40. Marrëdhëniet e Koncesionarit dhe Shoqërisë Koncesionare**
-

Aneksi 4A

Çeshtje financiare

Penalitetet e Zbatueshme per Koncesionarin

Koncesioneri do t'i paguaje Autoritetit Pagesat e Vonases si vijon:

1. Themelimi i shoqerise se re koncesionare per zbatimin e projektit

Konçesioneri do t'i paguaje Autoritetit nje penalitet si vijon per çdo jave te plote ne te cilen Konçesioneri deshton ne themelimin e shoqerise se re koncesionare, (siç percaktohet ne Aneksin 8):

Java e pare eshte periudhe falje e si rrjedhim:

2000 Euro ne jave per javen (tjeter) e pare vonese pas Javes se Pare

3000 Euro ne jave per javen e dyte vonese pas Javes se Pare

4000 Euro ne jave per javen e trete vonese pas Javes se Pare

5000 Euro ne jave per javen e katert vonese pas Javes se Pare

Shuma maksimale e penaliteteve per keto vonesa do te jete ne total 14.000 Euro.

Pas javes se peste te voneses, Autoriteti mund te kerkoje zgjidhjen e Kontrates.

2. Paraqitja e Plan Projektit Perfundimtar prane Autoritetit Kontraktor.

Konçesioneri do t'i paguaje Autoritetit nje penalitet si vijon per çdo jave te plote ne te cilen Konçesioneri deshton te paraqitjen prane Autoritetit te Plan Projektit Perfundimtar (siç percaktohet ne Aneksin 8):

Java e pare eshte periudhe falje e si rrjedhim:

1000 Euro ne jave per javen (tjeter) e pare vonese pas Javes se Pare

2000 Euro ne jave per javen e dyte vonese pas Javes se Pare

3000 Euro ne jave per javen e trete vonese pas Javes se Pare

4000 Euro ne jave per javen e katert vonese pas Javes se Pare

Shuma maksimale e penaliteteve per keto vonesa do te jete ne total 14.000 Euro.

Pas javes se peste te voneses, Autoriteti mund te kerkoje zgjidhjen e Kontrates. .

Pas pageses se penaliteteve te tilla, nese Konçesioneri eshte i suksesshem ne arritjen e afateve te tjera vijuese sipas Aneksit 8, Autoriteti do te ktheje ose kompensoje kete penalitet me detyrime te tjera te mundshme te tij, sipas zgjidhjes me te pershtatshme.

3. Aplikimi per Leje, Autorizime dhe/ose Licensa per efekt te Fillimit te Punimeve

Konçesioneri do t'i paguaje Autoritetit nje penalitet si vijon per çdo jave te plote ne te cilen Konçesioneri deshton ne Aplikimin per Leje, Autorizime dhe/ose Licensa per efekt te Fillimit te Punimeve (siç percaktohet ne Aneksin 8):

Java e Pare eshte periudhe falje e si rrjedhim:

2000 Euro ne jave per javen (tjeter) e pare vonese pas Javes se Pare

3000 Euro ne jave per javen e dyte vonese pas Javes se Pare

4000 Euro ne jave per javen e trete vonese pas Javes se Pare

5000 Euro ne jave per javen e katert vonese pas Javes se Pare

Shuma maksimale e penaliteteve per keto vonesa do te jete ne total 14.000 Euro.

4. Fillimi i Punimeve

Konçesioneri do t'i paguaje Autoritetit nje penalitet si vijon per çdo jave te plote ne te cilen Koncesioneri deshton ne fillimin e punimeve (siç percaktohet ne Aneksin 8):

Java e pare eshte periudhe falje e si rrjedhim:

5.000 Euro per nje periudhe vonese prej 3 (tre) javesh pas Javes se Pare

6.000 Euro per nje periudhe vonese prej 6 (gjashte) jave pas Javes se Pare

7.000 Euro per nje periudhe vonese prej 9 (nente) jave pas Javes se Pare

8.000 Euro per nje periudhe vonese prej 12 (dymbedhete) jave pas Javes se Pare

Shuma maksimale e penaliteteve per keto vonesa do te jete ne total 26.000 Euro.

Pas pageses se penaliteteve te tilla, nese Konçesioneri eshte i sukseshem ne arritjen e afateve te tjera vijuese sipas Aneksit 8, Autoriteti do te ktheje ose kompensoje kete penalitet me detyrime te tjera te mundshme te tij, sipas zgjidhjes me te pershtatshme.

5. Zbatimi i Punimeve

Ne zbatim te paragrafit 13.1 te kesaj Kontrate mbi realizimin e planit-te-punimeve ne zera dhe ne vlera, nese Konçesionari deshton ne realizimin e punimeve do te aplikohen keto penalitete:

Ne tre vitet e para duke filluar nga data e fillimit te punimeve nuk do te aplikohen penalitete pavaresisht plotesimit te pjesshem te realizimit te punimeve. Ne perfundim te vitit te trete, Konçesionari eshte i detyruar qe brenda nje periudhe 6(gjashte) mujore te plotesoje te gjitha punimet e perealizuara ne perputhje me deklaratat vjetore. Pas kesaj periudhe Konçesionari do te paguaje 0.04^o% te vleres se investimit te perealizuar per cdo jave vonese.

Per vitet ne vijim (duke filluar nga viti i peste deri ne perfundim te punimeve), Konçesionarit do t'i njihet nje periudhe 3(mujore) per te plotesuar te gjitha punimet e perealizuara per vitin paraardhes, pa u konsideruar ne vonese. Pas kesaj periudhe Konçesionari do te paguaje 0.04^o% te vleres se investimit te perealizuar per cdo jave vonese. Ne rast se ne momentin e leshimit te Certifikates se Pranimit, do te rezultojte siperfaqe e pandare te pambjelle me ullinj ne masen mbi 1 ha (per faj te Konçesionarit), Autoriteti ka te drejte te marre nga Konçesionari ate siperfaqe toke te pashfrytezuar.

Ne rast se ne momentin e leshimit te Certifikates se Pranimit, rezulton mosrealizim te mbjelljes se rrenjeve te ullirit (sipas Konçesionarit eshte propozuar nje mbjellje mesatare prej 500 rrenje/ha), ne zbatim te Nenit 29.1.5, Shoqeria Konçesionare do te paguaje nje penalitet prej 30^o% te kosos se mbjelljes per cdo rrenje, per cdo vit vonese.

Cdo vonese ne shlyerjen e detyrimeve monetare e ngarkon Konçesionarin me nje penalitet prej 0.04 % ne muaj te vleres se pashlyer te ketij detyrimi.

Aneksi 4B

Çeshtje financiare

Penalitetet e Zbatueshme per Autoritetin

Autoriteti do t'i paguaje Shoqerise Koncesionare Pagesat e Voneses si vijon:

1. Mos dorezimi ne kohe i siperfaqes se tokes me dokumentacionin e nevojshem sipas afateve te percaktuara ne kontrate.

Autoriteti do t'i paguaje Koncesionarit nje penalitet si vijon per çdo jave te plote ne te cilen Autoriteti deshton ne dorezimin ne kohe te siperfaqes dhe dokumentacionit te tokes:

3 (tre) muajt e pare eshte periudhe falje dhe pas kesaj periudhe do te paguhet nje penalitet prej 40.000 Euro ne muaj.

2. Mos respektimi i afateve ligjore ne pajisjen me leje, licenca, autorizime nga Autoriteti ose Entet Shteterore ne varesi te tij.

Autoriteti do t'i paguaje Koncesionerit nje penalitet si vijon per çdo jave te plote ne te cilen, pas mbarimit te periudhes te percaktuar ne Nenin 7.8, Autoriteti ose Entet Shteterore ne varesi te tij deshton/deshtojne ne pajisjen me leje, licensa, autorizime.

1000 Euro ne jave per javen (tjeter) e pare vonese pas Javes se Pare

2000 Euro ne jave per javen e dyte vonese pas Javes se Pare

3000 Euro ne jave per javen e trete vonese pas Javes se Pare

4000 Euro ne jave per javen e katert vonese pas Javes se Pare

Shuma maksimale e penaliteteve per keto vonesa do te jete ne total 14.000 Euro.

Cdo vonese ne shlyerjen e detyrimeve monetare e ngarkon Autoritetin me nje penalitet prej 0.04 % ne muaj te vleres se pashlyer te ketij detyrimi.

Aneksi 5:

VERTETIM PER DHENIE NE DOREZIM

Ne zbatim te Kontrates se Koncesionit “ _____ ” date ____ __ 2008, e nenshkruar ndermjet Autoritetit dhe Koncensionarit, ky-i fundit-bie dakord dhe pranon nga Ministria e Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit sipas gjendjes dhe pershkrimit te meposhtem:

Vendndodhja (Adresa)	Pershkrimi i Objektivit
	Te paraqitet qarte gjendja aktuale e objektit ku perfshihen ndertime pa leje, zenie informale, nderhyrje apo perdorime te paligjshme nga te trete. Per reference mund te perdoren edhe prova materiale si fotografi, materiale filmike, etj
Pershkrim i Dokumentacionit Shoqerues	1. Vertetimi ose Certifikata e Pronesise 2. Harta Treguese 3. Plan Rilevimi Bashkelidhur materialet perkatese
Te tjera:	

Koncensionari bie dakord dhe pranon dorezimin e objektit sipas pershkrimit te mesiperem.

Zbatuar ne _____ Republiken e Shqiperise me _____.

(Emri)

(Pozicioni)

Perfaqeson dhe vepron ne emer te

Ministrise se Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit te Republikes se Shqiperise

Emri)

(Pozicioni)

Perfaqeson dhe vepron ne emer te Koncensionarit

Aneksi 6:

Procedura e Ndryshimeve te Kontrates

1. Parime te Pergjithshme

Ky Aneks (**Procedura e Ndryshimeve te Kontrates**) percakton proceduren per trajtimin e Ndryshimeve te Kontrates.

Pa paragjykuar asnje nga dispozitat e kesaj Kontrate, te dy palet:

- (a) pranojne nevojën për të vepruar në mënyrë të arsyeshme në të gjitha rastet lidhur me menaxhimin, propozimin, miratimin dhe refuzimin e Ndryshimeve të Kontrates; dhe
- (b) marrin përsipër të veprojnë në mënyrë të arsyeshme në lidhje me menaxhimin, propozimin, miratimin dhe refuzimin e Ndryshimeve të Kontrates.

2. Kerkesa per Ndryshim

Secila pale mund t'i beje nje Kerkese per Ndryshim pales tjeter ne çdo kohe gjate Kohezgjatjes se Kontrates.

3. Autorizimi i Ndryshimit

Asnje Ndryshim Kontrate i perpunuar sipas ketij Aneksi nuk do te autorizohet dhe zbatohet nese nuk eshte miratuar dhe nenshkruar nga Palet.

Dokumenti i Autorizimit të Ndryshimit

Nr.	Titulli:	Data e paraqitjes:	Paraqitur nga:
Projekti	Kerkuar deri me daten		
Detaje te kerkesave te lidhura me Ndryshimin e Kontrates dhe me Dokumentet e Autorizimit te Ndryshimit			
Pershkrim i hollesishem i Ndryshimit te Kontrates			
Afatet e parashikuara kohore			

Detaje lidhur me fazat dhe me grafikun e zbatimit
Detaje te varesive te tjera (duke perfshire çdo kontribut te kerkuar nga Pala kerkuese)
Detaje te produkteve rezultuese per dorezim

Autorizimi i Ndryshimit te Kontrates (Po/Jo)		
Autorizim :		
	Firma:	Data:
	Firma:	Data:
Detaje shtese lidhur me vendimin (nese kerkohen)		
Kerkese per Pune/Numri i Kuotes	Numri i Urdhrit	Konfirmimi i Realizimit

Aneks 7:

CERTIFIKATA E PRANIMIT TE DOREZIMIT

Ministria e Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit ("Autoriteti") ose [nje organ tjetër i autorizuar rregullisht] ne perputhje me Kontraten e Koncesionit per Kulturimin me Ullinj deri ne 1000 ha në Synej, Luz i Vogel, Kryevidh dhe Gose, Kavaje, e nenshkruar rregullisht, ndermjet Autoritetit dhe Koncesionarit me __ Dhjetor 2008, bie dakord dhe pranon kalimin nga Koncesionari tek Autoriteti te objekteve te meposhtme te Koncesionit:

OBJEKTET E KONCESIONIT	SPECIFIKIMET TEKNIKE DHE PERSHKRIMI
Masivi i Ullishtes	[Te dhena nga Koncesionari]
(a)	
(b)	
(c)	
(d)	
(e) Komponente te Tjere	
Etj.	
OBJEKTE TE TJERA (p.sh., dokumente, manuale)	

1. Asetet e mesiperme, kalohen nga Koncesionari tek Autoriteti ne perputhje me termat dhe kushtet e Kontrates.
2. Autoriteti miraton dhe pranon objektet e mesiperme te Koncesionit nga Koncesionari tek Autoriteti ne perputhje me termat dhe dispozitat e Kontrates.

Zbatuar ne [_____], me _____.

(Emri): _____

(Pozicioni): _____

Perfaqeson dhe vepron ne emer te Ministrise se Bujqesise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit te Republikes se Shqiperise

Aneksi 8

Plani i Projektit

Pikesynimet kryesore te Konçesionit jane:

	Pershkrimi i Detyrave te Koncesionarit	Afati
1	<u>Themelimi i shoqerise se re koncesionare per zbatimin e projektit</u>	Data Efektive + 30 dite (11)
2	<u>Paraqitja e Plan Projektit Perfundimtar prane Autoritetit Kontraktor.</u>	Data e Dorezimit te Siperfaqes se Tokes + 12 (dymbedhete) muaj (12)
3	<u>Aplikimi per Leje, Autorizime dhe/ose Licensa per efekt te Fillimit te Punimeve</u>	12 + 3 (tre) muaj (13)
4.	<u>Fillimi i Punimeve</u>	13 + 3 (tre) muaj (14)
5.	<u>Perfundimi i Punimeve</u>	14 + 7 (shtate) vjet

Programi i hollesishem ne lidhje me zbatimin e punimeve dhe fazat e tij, do te paraqitet nga Koncesionari sipas paragrafit 13.1 te Kontrates.

Aneksi 9

Plani i Testimit

1. Hyrje

Nje muaj perpara fillimit te fazes se pranimi te punimeve, Konçesioni do te dergoje nje plan te testimit me qellim qe te verifikojë perputhshmerine e sistemit te vendosur me percaktimet e hollesishme te tij siç percaktohet ne Aneksin 2 dhe 3.

Konçesioni do t'i siguroje Autoritetit per miratim Planin e Testimit, siç percaktohet ne paragrafin e mesiperm.

2. Organizimi i Testit te Pranimi

Organizimi i Testit te Pranimi bazohet kryesisht ne percaktimin e hollesishem te proçeseve te punes te percaktuar ne Aneksin 3.

3. grafiku

Aneksi 10

Procedura e Zgjidhjes se Mosmarreshjeve

Permbajtja

1. Hyrje
2. Shkallet
3. Percaktimi i Eksperteve
4. Performanca e vazhdueshme

1. Hyrje

- 1.1 Cdo mosmarreveshje do te zgjidhet ne perputhje me Proceduren e Zgjidhjes se Mosmarreveshjeve te percaktuar ne kete Aneks.

2. Shkallet

- 2.1 Nese ndermjet Autoritetit dhe Koncesionarit do te lindre ndonje ceshtje qe perben shqetesim, atehere Palet do te bejne te gjitha perpjekjet e arsyeshme per ta zgjidhur nje ceshtje te tille ne menyre sa me te shpejte dhe praktike qe te jete e mundshme, ne ate nivel qe nje mosmarreveshje e tille do te krijohet. Minimalisht, palet do te sigurojne se e kane diskutuar ceshtjen ne driten e fakteve qe lidhen me ceshtjen, qe e kane kaluar ate neper nivelet operative, menaxheriale dhe ekzekutive te shqyrtimit (sipas mundesise) dhe se kane bere te gjitha perpjekjet e arsyeshme per te arritur ne nje zgjidhje.
- 2.2 Sipas Paragrafit 4 te ketij Aneksi, kur Palet nuk arrijne nje zgjidhje per mosmarreveshjen, ato do te perpiqen t'i zgjidhin ne funksion te pershkallezimit te mosmarreveshjes, duke perdorur Procesin e Shkallezimit te percaktuar ne kete Aneks, perpara nisjes se nje procedure alternative te zgjidhjes se mosmarreveshjes nepermjete emerimit te nje eksperti apo grupi ekspertesh.
- 2.3 Ku lind nje ceshtje, e cila nuk mund te zgjidhet ne ate nivel qe kjo ceshtje lind, atehere Autoriteti ose Koncesionari mund ta dergojne ate prane nivelit tjetere ne procesin e Shkallezimit.
- 2.4 Prosesi i Shkallezimit synon te jete nje udhezues per palet lidhur me zgjidhjen e ceshtjeve ne menyre po aq te shpejte sa ato linden. Synimi nuk eshte qe Prosesi i Shkallezimit te funksionojte ne menyre jo fleksibel apo ne nje menyre te tille qe pengojte zgjidhjen e nje ceshtje ne nivelin me te pershtatshem dhe sa me shpejt qe te jete e mundur.
- 2.5 Kur, ne cdo nivel, vendoset qe ceshtja ka kaluar neper shkalle sipas menyres se duhur, Palet do te bejne te gjitha perpjekjet e arsyeshme per ta zgjidhur ceshtjen.
- 2.6 Kur pranohet nje zgjidhje, vendimi se bashku me planin e zbatimit do te raportohen me shkrim.
- 2.7 Kur nje ceshtje nuk mund te zgjidhet ne nje nivel, atehere ajo do te kalohet ne nivelin tjetere me te larte ne perputhje me Paragrafin 2.4 me siper.

2.8 Përveç rasti kur një çështje kërkon zgjidhje të shpejta, ku veprimet e Autoritetit janë ose mund të ndikohen negativisht ose kur secila Palë mund të pësojë kosto domethënëse si rezultat i moszgjidhjes së çështjes, referimi i çështjes do të bëhet me raport të shkruar për tek nivelin tjetër nga Pala e cila referon çështjen. Raporti do të përmbajë, të paktën informacionin e mëposhtëm:

- Emrin dhe adresën e iniciatorit;
- Data kur është ngritur çështja për herë të parë;
- Përshkrimi i çështjes, duke përfshirë çdo histori me probleme të ngjashme;
- Implikimet e çështjes, seriozitetin e saj dhe shkallën e urgjencës që kërkohej;
- Një vlerësim të kostos aktual dhe potenciale të çështjes; dhe
- Emrat dhe adresat e të tjerëve të përfshirë, të cilët mund të ketë nevojë të konsultohen.

2.9 Brenda 5 (pese) dite pune nga marrja e vendimit për shkallëzimin, iniciatori dhe homologu i tij do të përgatisin dhe pranojnë një raport për nivelin tjetër dhe homologut do t'i jepet një kopje e raportit. Kur raporti nuk mund të pranohet, atëherë çdo vërejtje shtesë që mund të kërkojë Pala tjetër, do t'i bashkelidhet raportit.

2.10 Sapo raporti të jetë dorëzuar, personat përkatës të nivelit të dhënë do të kontaktojnë me njëri-tjetrin sa më shpejt që të jetë e mundur për të zgjidhur çështjen që është subjekt i referimit brenda një periudhe shtesë prej 5 (pese) ditësh pune pas së cilës, çështja do të referohet në nivelin pasardhës ose, do të zbatohen, në vijim të referimit të nivelit 4, procedurat e përcaktuara në paragrafet 3, 4 dhe 5.

Nivelet e shkallëzimit janë si më poshtë vijon:

Niveli	Autoriteti	Koncesionari
Niveli 1	Perfaqësuesi i Autoritetit	Menaxheri i Përgjithshëm i Kompanisë Koncesionare
Niveli 2	Zevendes Ministri	Drejtori i Përgjithshëm i Projektit
Niveli 3	Ministri i Autoritetit	Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë koncesionare

3. Percaktimi i Ekspertit

Nese nje mosmarveshje ne lidhje me nje **çeshtje teknike** nuk mund te zgjidhet me ane te Procesit te Shkallezimit, atehere mosmarveshja mundet, sipas nje marveshjeje ndermjet paleve, t'i referohet nje eksperti (**Eksperti**) per nje percaktim perfundimtar, i cili do te konsiderohet se vepron si ekspert dhe jo si arbiter; dhe

3.1 Eksperti do te zgjidhet me marveshje reciproke.

3.2 14 (katërmbëdhjetë) dite pasi Eksperti ka pranuar emerimin, palet do te dorezojne nje raport te shkruar lidhur me mosmarveshjen prane Ekspertit dhe prane njeri-tjetrit dhe 7 (shtate) dite me pas do te dorezojne me shkrim çdo koment qe ata deshirojne t'i bejne Ekspertit ose njeri-tjetrit.

3.3 Me pas, te dy palet do t'i sigurojne Ekspertit te gjithë asistencen e nevojshme qe do te kerkoje per te shqyrtuar mosmarveshjen duke perfshire, dhe jo vetem, aksesin e plote tek Sistemi dhe çdo dokumentacion apo korrespondence qe ka te beje me sistemin.

3.4 Eksperti do te udhezohet per te dhene percaktimin e tij per palet brenda 14 ditesh pas dorezimit te raporteve me shkrim ne zbatim te Paragrafit 3.3.

3.5 Vendimi i Ekspertit persa i perket akteve te ekspertimit do te jete i formes se prere dhe i detyrueshem dhe nuk mund te apelohet.

3.6 Tarifat per Ekspertin do te perballohen nga palet sipas raportit qe do te percaktohet nga Eksperti duke marre parasysh (nder te tjera) sjelljen e paleve.

4. Performanca e Vazhdueshme

4.1 Autoriteti dhe Koncesionari do te vazhdojne permbushjen e detyrimeve te tyre sipas kesaj Kontrate ne pritje te zgjidhjes se mosmarveshjes, me kusht qe asgje qe permban ky Aneks nuk pengon apo kufizon Palet ne lidhje me ushtrimin e ligjshem te se drejtave te tyre, ne çdo kohe.

Aneksi 11

FORMULARI I SIGURIMIT TE KONTRATES

GARANCI BANKARE / SHOQERI SIGURIMI

Nr. ref. _____

Data __ __ 2008

Per : Emri i Autoritetit kontraktues
Adresa e Autoritetit kontraktues

Duke qene se (*emri i kontraktuesit*) ka marre persiper ne baze te Kontrates Nr. date te realizoje (*emertimi dhe pershkrim i shkurter i objektit te kontrates*):

Duke qene se ne Kontraten tuaj kerkohet *Garanci Bankare/ Sigurim* ne shumen e specifikuar ne te, si sigurim per permbushjen e detyrimeve te parashikuara ne kontrate :

Duke qene se (*emri dhe adresa e Bankes/ Shoqerise se Sigurimit*) eshte dakord te leshoje kete garanci :

Deklarojme se ne jemi garantuesit e kontrates se mesiperme deri ne shumen totale prej (*shuma ne shifer dhe fjale*), shume e cila eshte e pagueshme ne menyren dhe monedhen e percaktuar ne kontrate. Ne marrim persiper te paguajme, sapo te beni kerkesen e pare me shkrim dhe pa qene nevoja te beni argumentim te kerkeses, cdo shume brenda kufirit prej (*shuma e garancise*).

Me kete garanci ju sigurojme se nuk eshte nevoja ti drejtoheni me pare Kontraktuesit per te realizuar pagesen sipas kerkeses suaj.

Deklarojme gjithashtu, se asnje shtese apo ndryshim i kushteve te kontrates, per te cilen ju mund te bini dakord me kontraktuesin, nuk na cliron nga detyrimet e kesaj Garancie.

Kjo garanci eshte e vlefshme deri ne daten qe perfshin 30 dite nga data e leshimit te Certifikates se Testimit.

Nenshkrimi dhe Vula e Bankes/Shoqerise se Sigurimit

Aneksi 12

PERSHKRIMI I SIPERFAQES SE DHENE ME KONCESION

Ne baze te ofertes se Koncesionarit, per te cilen eshte shpallur dhe fitues, siperfaqja e tokes qe jepet me koncesion do te jete 1000 (nje mije) ha. Kjo siperfaqe toke perfshihet brenda hartes treguese te paraqitur ne Oferte. E gjithë siperfaqja e perfshire ne harte deri ne 1000 ha, do te jete objekt i Koncesionit. ~~Percaktimi i sakte i siperfaqes se tokes ne terren do te behet gjate Procedures se Dorezimit, nepermjet nje grupi te perbashket pune, per te reflektuar gjendjen faktike sipas hartes se pranuar ne oferten e Koncesionarit te siperfaqes qe do te jepet me Koncesion, duke patur parasysh se gjithë siperfaqja qe mund te ekzistojë sipas dokumenteve standarte te procedures konkurruese nga 700 ha deri ne 1000 ha do te jete objekt vetem i ketij Koncesioni.~~

Ne cdo rast, Projekti do te shtrihet ne pjese te pandara toke me qellim sigurimin e shtrirjes se tij per perdorim eficient.

Dokumentacioni perkates i hartur nga grupi i perbashket do te konsiderohet pjese e dokumentacionit te regjistrimit te tokes e dorezuar nga Palet ne Zyren perkatese te Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme.

Ne paraqitjen e dokumentacionit do te merren parasysh edhe dispozitat e paragrafit 22.5.12.

Aneksi 13

Kushtet Standarte te Nenkontraktimit

Cdo Nenkontraktor qe ka lidhur nje marreveshje per ekzekutim punimesh me Shoqerine Koncesionare, duhet te plotesoje kushtet e meposhtme:

1. ~~Te kete aftesi te duhura per kryerjen e punimeve per te cilat nenkontraktohet;~~
2. Te kete kryer te pakten nje eksperience te ngjashme per sherbimet ose punet qe ajo merr persiper te kryeje;
3. Te kete kapacitet financiar per te kryer punime ose sherbimet e marra persiper.

Sa me siper, Koncesionari do te paraqese prane Autoritetit dokumentet qe vertetojne kushtet e mesiperme. Ne rast mungese te tyre, keto kushte mund te verterohen nepermjet nje vetedeklarimi nga ana e Koncesionarit.